



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2014 – Numri: 205

Tiranë – E Enjte, 8 Janar 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 76, datë 18.12.2014	Për miratimin e rregullores “Për funksionimin e sistemit qendror të regjistrimit dhe shlyerjes së titujve (AFISaR)”..... 12343

**VENDIM****Nr. 76, datë 18.12.2014****PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR FUNKSIONIMIN E SISTEMIT
QENDROR TË REGJISTRIMIT DHE
SHLYERJES SË TITUJVE (AFISaR)”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronjat “b” dhe “ç”, të nenit 3, pika 2, pika 4, shkronja “d”, të nenit 25, pika 2, të nenit 29, të nenit 43, shkronja “c”, të nenit 53, pika 4, paragrafi i fundit i ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të ligjit nr. 9879, datë 21.2.2008, “Për titujt”; të nenit 31 të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas së Republikës së Shqipërisë”; ligjit nr. 133/2013, datë 29.4.2013, “Për sistemin e pagesave”; të marrëveshjes ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave “Për organizimin e ankandëve të titujve të Shtetit Shqiptar, shlyerjen e veprimeve dhe mbajtjen e regjistrit të këtyre titujve”, nënshkruar nga palët në datë 26.12.2013; marrëveshjes ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave, nënshkruar në datë 26.03.2003, si dhe akteve të tjera nënligjore të Bankës së Shqipërisë që rregullojnë Sistemet AIPS, AECH, LORO, ATM; me propozimin e Departamentit të Operacioneve Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Për funksionimin e sistemit qendror të regjistrimit dhe shlyerjes së titujve (AFISaR)”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Të autorizojë Drejtorin e Departamentit të Operacioneve Monetare të nënshkruajë kontratat tip për pjesëmarrjen në sistemin AFISaR, sipas përmbajtjeve të shtojcave nr. 1, nr. 2, nr. 3, si dhe kontratën tip ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe bankave: “Për shlyerjen e transaksioneve në cash që gjenerohen nga veprimet me tituj të personave fizikë që e kanë llogarinë e titullit në Bankën e Shqipërisë”, sipas përmbajtjes së shtojcës nr. 4, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të rregullores.

3. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Departamenti i Operacioneve Monetare,

Departamenti i Sistemeve të Pagesave dhe i Kontabilitetit dhe Financës dhe Departamenti i Teknologjisë së Informacionit në Bankën e Shqipërisë, si dhe pjesëmarrësit e sistemit AFISaR.

4. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit për publikimin e këtij vendimi dhe të rregullores “Për funksionimin e sistemit qendror të regjistrimit dhe shlyerjes së titujve (AFISaR)” në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

5. Me hyrjen në fuqi të Rregullores “Për funksionimin e sistemit qendror të regjistrimit dhe shlyerjes së titujve (AFISaR)”, shfuqizohet rregullorja “Për transaksionet me titujt ndërmjet bankave dhe funksionimin e sistemit të regjistrimit të titujve”, miratuar me vendimin nr. 61, datë 29.07.2009, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETARI
Elisabeta Gjoni

**KREU I
TË PËRGJITHSHME****Neni 1
Objekti**

Objekti i rregullores është përcaktimi i rregullave dhe i procedurave për organizimin dhe funksionimin e sistemit qendror të regjistrimit dhe të shlyerjes së titujve (AFISaR: Albanian Financial Instrument Settlement and Registration).

**Neni 2
Baza juridike**

Rregullorja nxirret në bazë dhe për zbatim të:

a) ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

b) ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008, “Për titujt”;

c) ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

d) ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas së Republikës së Shqipërisë”;

e) ligjit nr. 133/2013, datë 29.04.2013, “Për sistemin e pagesave”;



f) marrëveshjes kuadër ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave;

g) akteve nënligjore të fushës të Bankës së Shqipërisë.

Neni 3

Fusha e zbatimit

Subjekte të zbatimit të rregullores, janë pjesëmarrësit dhe administratori i sistemit AFISaR.

Neni 4

Përkufizime

Në zbatim të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. Agjent shlyerës – është banka që ka llogari shlyerje në sistemin e pagesave AIPS të Bankës së Shqipërisë dhe që mund të lidhë kontrata me pjesëmarrësit e sistemit AFISaR për t'u ofruar llogarinë e saj në sistemin AIPS për shlyerjen e veprimeve të tyre, ose Banka e Shqipërisë, si administrator i Sistemit AIPS;

2. ALL (Albanian Lek) - është kodi i përcaktuar për monedhën shqiptare në “ISO 4217 on Currency Codes”;

3. Akses - është e drejta dhe/ose mundësia e një pjesëmarrësi që të përdorë shërbimet e një sistemi të caktuar pagesash, për të shlyer pagesa për llogari të tij, ose të klientëve të tij;

4. Anëtarësimi në sistemin AFISaR - është procedura që kryen një pjesëmarrës, nën kujdesin e administratorit të sistemit AFISaR, për t'u bërë pjesëmarrës i tij;

5. Autoritete përkatëse – janë autoritetet, vendase ose të huaja, të cilat licencojnë dhe/ose mbikëqyrin personat juridikë për veprimtarinë me tituj;

6. Autorizim RMA (Relationship Management Application) - është shkëmbimi i kredencialeve në shërbimin përkatës të SWIFT-it që mundëson menaxhimin e marrëdhënieve të biznesit;

7. Certifikatë dixhitale - është një tërësi të dhënash elektronike, të cilat shërbejnë për certifikimin e identitetit të përdoruesve gjatë përdorimit të sistemit AFISaR dhe për certifikimin e autenticitetit të informacioneve të dërguara/marra;

8. Certifikimi i pjesëmarrësit në sistemin AFISaR - është hapi final i anëtarësimit, gjatë të cilit një pjesëmarrës pajiset me certifikatë për pjesëmarrje në AFISaR;

9. Databazë - është bashkësia e të dhënave të ruajtura në formë të strukturuar elektronike;

10. Datë valuta - është data në të cilën është urdhëruar ekzekutimi i shlyerjes së urdhërpagesës;

11. Data e shlyerjes - është data në të cilën kryhet shlyerja e pagesave. Data e shlyerjes dhe data e valutës mund të kenë të njëjtën datë kalendarike;

12. Ditë pune e sistemit - është një interval i paracaktuar kohe gjatë një dite jopushimi, brenda të cilit urdhërpagesat pranohen, procesohen dhe shlyhen nga sistemi AFISaR;

13. Data e shlyerjes finale – është data e përcaktuar në njoftimin e ankandit si data finale për shlyerjen e transaksioneve të gjeneruara nga pjesëmarrja në ankand, pas të cilës ky transaksion anulohet;

14. Dita e regjistrimit – është dita në të cilën njihen zotëruesit e titullit, të cilët do përfitojnë pagesat që lidhen me titullin si maturimet/pagesat e interesit. Mbas ditës së regjistrimit që ndodh para një ngjarjeje pagesash, nuk lejohet kryerja e veprimeve që mund të sjellin ndryshim në zotëruesit e titullit, deri në kalimin e ditës e kryerjes së pagesave;

15. Dorëzim kundrejt pagesës (DVP)- është parimi i cili siguron shlyerjen përfundimtare dhe të pakthyeshme të një transaksioni instrumentesh financiare ku transfertat e pakthyeshme dhe e pakushtëzuar e instrumenteve nga shitësi tek blerësi, ndodh vetëm nëse ndodh transferimi i pakthyeshem dhe i pakushtëzuar i fondeve nga blerësi tek shitësi;

16. DVP- cut off – është procedura e realizuar në sistemin AFISaR për mbylljen e shërbimit për shlyerjen e instruksioneve të pagesave DVP;

17. Fallback – Recovery - është procedura e kthimit të sistemit në një situatë normale, pasi ka patur një dështim të funksionimit të sistemit primar;

18. FIFO (First in – First out) - është parimi i cili bën vendosjen në radhë të urdhër pagesave, në varësi të momentit të mbërritjes në sistem dhe ku urdhër pagesa e parë e mbërritur në radhën e çdo pjesëmarrësi, shlyhet e para;

19. Firewall - është një sistem hardware dhe software, i cili bllokun ose lejon trafikun në rrjetin e brendshëm dhe të jashtëm të Bankës së Shqipërisë;



20. FOP cut-off - është procedura e realizuar në sistemin AFISaR për mbylljen e shërbimit për shlyerjen e instruksioneve të pagesave për transfertat FOP;

21. Instruksion pagese - është një mesazh elektronik, që përmban detaje të kërkesës për shlyerje apo të urdhërpagesës;

22. Klerimi - është procesi i krahasimit dhe përlogaritjes së detyrimeve reciproke të pjesëmarrësve në transaksionin e shitblerjes, në bazë neto ose për çdo transaksion, me qëllim shkëmbimin e titullit kundrejt vlerës monetare;

23. KBD cut-off - është procedura e realizuar në sistemin AFISaR për mbylljen e shërbimit për kredinë brenda ditës;

24. Kodi i identifikimit të bankës (Bank Identifier Code) - është një kod unik, i përcaktuar nga SWIFT për çdo pjesëmarrës në shlyerje, dhe shërben për identifikimin e pjesëmarrësve në sistemin AFISaR;

25. Kompania SWIFT - (Society for Worldwide Interbank Financial Telecommunication) është kompania ndërkombëtare, e cila ofron shkëmbim global të sigurt mesazhesh FIN dhe skedarësh;

26. Kontrata tip - është Kontrata e Pjesëmarrjes në AFISaR, sipas shtojcave 1, 2 dhe 3 të kësaj rregulloreje, e cila lidhet mes administratorit dhe pjesëmarrësit, për ofrimin e shërbimeve të regjistrimit dhe shlyerjes së transaksioneve me tituj. Në të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese, të cilat rrjedhin nga pozicionet e tyre në sistem në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje;

27. Kundërpala – është pala që ka pozicionin e kundërt në një kontratë apo transaksion financiar;

28. Llogari omnibus – është llogari që hapet nga një pjesëmarrës i drejtpërdrejtë për klientët e tij dhe përmban një ose më shumë përfitues të pa identifikuar në mënyrë specifike;

29. Lirimi i titullit të vendosur kolateral – është kalimi i titullit të bllokuar nga sektori “kolateral” i llogarisë së pjesëmarrësit, në llogarinë e tij, duke iu shtuar balancës;

30. Llogari shlyerjeje - quhet llogaria e një pjesëmarrësi në sistemet e pagesave të Bankës së Shqipërisë, e cila përdoret për shlyerjen e transfertave të fondeve ose të titujve;

31. Manual i përdorimit – është manuali i përdorimit të sistemit AFISaR;

32. Manual i SWIFT-it – është manuali për përdorimin e tipave të mesazheve që pranon sistemi AFISaR;

33. Marrëveshje e kolateralit financiar – është marrëveshja që plotëson kriteret e përcaktuara në ligjin për sistemin e pagesave dhe që i nënshtrohet regjimit të ekzekutimit të përcaktuar në këtë ligj;

34. Mekanizmi Gridlock - është algoritmi që kryen sistemi për zgjidhjen e situatës Gridlock;

35. MF - është Ministria e Financave në Republikën e Shqipërisë;

36. Modeli DVP 1 - i referohet ndërtimit të mënyrës së shlyerjes së transaksioneve me tituj, sipas të cilës transferimi i titujve dhe i fondeve ndodh në bazë bruto (detyrim për detyrim), me transferimin final të parevokueshëm dhe të pakushtëzuar të titujve nga shitësi tek blerësi, pas transferimit të pakthyeshëm dhe të parevokueshëm të fondeve nga blerësi tek shitësi;

37. Modeli DVP 2 - i referohet ndërtimit të mënyrës së shlyerjes së transaksioneve me tituj, sipas të cilës transferimi i titujve ndodh në bazë bruto (transaksion për transaksion), ndërsa transferimi i fondeve ndodh në bazë neto (vetëm një transaksion për të gjitha transaksionet me tituj, duke netuar hyrjet me daljet e fondeve);

38. Ndërfaqe - janë produkte software, të cilat realizojnë bashkëveprimin midis sistemit AFISaR dhe sistemeve të tjera që operon administratori;

39. Ndërmjetës financiarë – janë persona juridikë të licencuar nga autoritetet përkatëse për të operuar në tregjet ku tregtohen titujt;

40. Nënshkrim dixhital – është enkriptimi i informacionit elektronik të transmetuar sipas një sistemi enkriptues, të bazuar në certifikatat dixhitale;

41. Ngjarje e paparashikuar - është një ngjarje që shkakton probleme në funksionimin normal të sistemit AFISaR;

42. Oficer sigurie - është punonjësi që krijon dhe administron përdoruesit në sistemin AFISaR;

43. Pajisje sigurie - janë hardware dhe software të konfiguruar për të implementuar procesin e krijimit, ruajtjes dhe verifikimit të certifikatave dixhitale;



44. Periudha e faljes – është periudha deri në të cilën ruhet pozicioni neto i krijuar nga një shlyerje në të njëjtën ditë të maturimeve dhe emetimeve të titujve;

45. Person fizik – është individi me zotësi të plotë juridike;

46. Pjesëmarrës në AFISaR - është personi juridik/fizik që identifikohet/njihet nga sistemi, të cilit i lejohet të dërgojë dhe të marrë, urdhërpagesa në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë;

47. Profil i pjesëmarrësit - është bashkësia e të dhënave të pjesëmarrësit, të cilat regjistrohen në sistem dhe e identifikojnë atë në mënyrë unike, sipas shtojcave 10 dhe 11 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të kësaj rregulloreje;

48. Procedura për paaftësi paguese – është çdo procedurë e përcaktuar në ligjet e Republikës së Shqipërisë apo të ndonjë vendi tjetër, me qëllim shpërbërjen e një personi juridik ose riorganizimin e tij, dhe që ka si pasojë ndër të tjera, pezullimin ose vendosjen e kufizimeve mbi transfertat apo pagesat;

49. Radhë - quhet renditja e instruksioneve të pagesave;

50. Rreziku i humbjes së principalit – është rreziku që shitësi i një titulli, të dorëzojë titullin, por të mos marrë pagesën, ose rreziku që blerësi i një titulli të bëjë pagesën, por të mos marrë titullin. Në këto raste, vlera principale e plotë e titullit ose e fondeve është në rrezik;

51. Rreziku i shlyerjes – është rreziku që një prej palëve/pjesëmarrës në sistemin AFISaR të mos përmbushë detyrimet kontraktore ndaj palës tjetër, në kohën e përcaktuar për shlyerjen e transaksionit. Rreziku i shlyerjes lidhet me falimentimin në momentin e shlyerjes, si dhe/ose me diferencat në kohën e shlyerjes që ka njëra palë nga tjetra. Ky lloj rreziku mund të çojë në rrezikun e humbjes së principalit;

52. Rreziku i likuiditetit – me të cilin mund të përballët një pjesëmarrës në sistemin AFISaR, është rreziku i dështimit për të paguar detyrimet financiare afatshkurtra, që mund të shkaktohet si rezultat i dështimit të një transaksioni me tituj, ku ky pjesëmarrës është në rolin e shitësit të titullit apo nga përdorimi i likuiditetit në llogarinë e tij nga klientët për të cilët ky pjesëmarrës është agjent shlyerës;

53. Rreziku i tregut – është rreziku i humbjeve, i shkaktuar nga lëvizja e çmimeve në tregje, që mund të shkaktohet nga dështimi i një transaksioni me tituj;

54. Rreziku operacional – është rreziku i humbjeve që mund të shkaktohen nga: pamjaftueshmëria, mungesa apo dështimi i procedurave të brendshme, i njerëzve, sistemeve apo nga ngjarje të jashtme;

55. Server - është një kompjuter, i cili siguron shërbime për kompjuterët e tjerë ose për software-in që ekzekutohet në të;

56. Server SWIFT - është serveri ku instalohen, konfigurohen programet aplikative të SWIFT-it, që bëjnë të mundur komunikimin me rrjetin SWIFT;

57. Shërbim - është një pjesë e programit aplikativ të sistemit AFISaR që kryen një funksion të caktuar;

58. Shlyerje - është procesi i kompletimit/përfundimit të transaksionit të shitblerjes, ku pala shitëse transferon titullin tek pala blerëse dhe kjo e fundit transferon vlerën monetare tek pala shitëse. Shlyerja në sistemin AFISaR mund të jetë me lëvizje fondesh, në përputhje me parimin DVP, ose pa lëvizje fondesh, në përputhje me parimin DFP;

59. Shlyerje në kohë reale - është shlyerja e ekzekutuar pa vonesë, menjëherë pas marrjes së instruksionit, në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje;

60. Shlyerje finale - është një shlyerje që është e përvokueshme dhe e pakushtëzuar;

61. Sistemi i regjistrimit të titujve Book Entry – është sistemi i operuar nga Banka e Shqipërisë për regjistrimin dhe shlyerjen e titujve të Qeverisë, i përdorur nga Banka deri në momentin e hyrjes live të sistemit AFISaR;

62. Sistem backup - është tërësia e hardware dhe software që shërben në situata emergjente, të jashtëzakonshme, kur sistemi primar del jashtë funksionimit;

63. Sistemi loro - është sistemi i administrimit të llogarive në valutë të të tretëve, që operohet nga Banka e Shqipërisë;

64. Sistemi RTGS – është sistemi që përdoret për shlyerjet në kohë reale të pagesave. Në kontekstin e përdorur në këtë rregullore, sistemi RTGS i referohet bashkësisë së sistemit AIPS dhe sistemit Loro;



65. Sistem live - është tërësia e hardware dhe software që shërben për veprimtarinë e zakonshme ditore të sistemit AFISaR;

66. Sistem test - është tërësia e hardware dhe software që shërben për efekt testimi të sistemit AFISaR;

67. Sistemi AFISaR (Albanian Financial Instrument Settlement and Registration) - është sistemi qendror i regjistrimit dhe i shlyerjes së titujve të Shtetit Shqiptar, për të cilët Banka e Shqipërisë organizon ankandin sipas marrëveshjes së lidhur midis saj dhe Ministrisë së Financave. Ky sistem mund të regjistrojë dhe të shlyejë edhe titujt që mund të emetojë Banka e Shqipërisë;

68. Sistemi AIPS (Albanian Interbank Payment System) - është Sistemi i Pagesave Ndërbankare me Vlerë të Madhe. Ky është sistem i shlyerjes bruto në kohë reale të urdhërpagesave në lekë, me rëndësi sistematike brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, në mënyrë të parevokueshme dhe të pakushtëzuar;

69. Situatë Gridlock - është një situatë që ndodh me transfertat e fondeve ose të titujve, në të cilën mosekzekutimi i një instruksioni pagese (për shkak të pamjaftueshmërisë së fondeve ose titujve), bllokun ekzekutimin e një numri pagesash të tjera, të urdhëruara nga pjesëmarrës të tjerë të sistemit;

70. Tituj - janë vetëm titujt e dematerializuar;

71. Të dhënat e përgjithshme të ankandit – janë të gjitha të dhënat që janë pjesë e njoftimit për ankandin në tregun primar të titujve;

72. Transferta pa pagesë (FOP) – janë transfertat të titujve, të cilat nuk shoqërohen me transfertat të fondeve;

73. Transferta pa dorëzim (FOD) – janë transferime të fondeve që urdhërohen nga AFISaR për sistemet e shlyerjes së fondeve, të cilat nuk janë të shoqëruara me transfertat të titujve;

74. Transferta dorëzim kundrejt dorëzimit – janë transfertat të titujve që ndodhin kundrejt transfertave të titujve;

75. Treg primar – është hapësira fizike ose funksionale në të cilën emetuesi nxjerr për shitje (emeton) për herë të parë titujt;

76. Treg sekondar – është hapësira fizike ose funksionale ku kryhen transaksionet me titujt, pasi ato janë emetuar së pari në tregun primar;

77. Urdhërpagesë - është një instruksion në formë elektronike, për kryerjen e një pagese në sistemin AFISaR, me anë të të cilit një pjesëmarrës kërkon transferimin e titujve, ose në sistemin AIPS, me anë të të cilit një pjesëmarrës kërkon transferimin e fondeve;

78. VPN (Virtual Private Network) – është rrjet virtual privat që përdoret ekskluzivisht nga pjesëmarrësit në sistemin AFISaR për të mundësuar hyrjen në sistemin qendror AFISaR, me qëllim kryerjen e veprimeve dhe monitorimin e llogarisë;

79. Workstation - është platformë e përfshirë në sistemin AFISaR, përmes së cilës pjesëmarrësit që kanë akses në AFISaR dërgojnë instruksionet e pagesave nëpërmjet VPN-së;

80. Webstation AFISaR - është akses i dhënë pjesëmarrësve në sistemin AFISaR.

KREU II PARIMET E SISTEMIT

Neni 5 Roli i sistemit

Sistemi AFISaR luan dy role:

a) bën lidhjen midis emetuesit, i cili depoziton titujt në këtë sistem, dhe ndërmjetësve financiarë, të cilët i mbajnë këto tituj në llogarinë e tyre apo të klientëve të përfaqësuar prej tyre. Në këtë rol, sistemi kryen të gjitha ngjarjet që ndodhin midis emetuesit dhe ndërmjetësve financiarë, duke realizuar detyrat si regjistruer i titujve;

b) bën shlyerjen e transaksioneve me titujt, duke lejuar pjesëmarrësit të dorëzojnë tituj kundrejt pagesës dhe të bëjnë transfertat pa pagesë, duke realizuar detyrat e klerimit dhe shlyerjes së titujve.

Neni 6 Instrumentet

1. Sistemi AFISaR është sistem qendror i regjistrimit dhe i shlyerjes të titujve të Shtetit Shqiptar të emetuara nga Ministria e Financave, për të cilat Banka organizon ankandet, të dakorduara në marrëveshjen e lidhur midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave.

2. Përveç instrumenteve financiare të përmendura në pikën 1, në Sistemin AFISaR do të regjistrohen dhe do të shlyhen edhe titujt që



mund të emetojë Banka e Shqipërisë në përputhje me ligjin “Për Bankën e Shqipërisë”.

Neni 7

Administratori

Banka e Shqipërisë është i vetmi pronar dhe administrator i sistemit AFISaR.

Neni 8

Mënyra e operimit

Sistemit AFISaR funksionon bazuar në sistemin e mbajtjes së llogarive në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, me të cilën kuptohet që ka ndërmjetës financiarë midis emetuesit dhe investitorit fundor.

Neni 9

Menaxhimi i rreziqeve

1. Rreziku i shlyerjes menaxhohet nëpërmjet karakteristikave të mëposhtme të sistemit:

a) Eliminon rrezikun e humbjes së principalit duke lidhur transfertën e titujve me transfertën e fondeve në mënyrë të tillë që arrihet realizimi i parimit “dorëzim kundrejt pagesës (DVP)”;

b) Nuk ka kufizim kohor në arritjen e shlyerjes finale që nga momenti i hyrjes së urdhrave për shlyerjen e transaksioneve dhe realizimit të të gjitha hapave të përshkruara në nenin 11, që sigurojnë realizimin e parimit DVP;

c) Sistemi ofron mundësinë për operacionet e kredisë brenda ditës dhe të huadhënies të titujve, si lehtësi që ndihmojnë në zgjidhjen e situatave kur një nga palët në kontratë nuk ka mundësi shlyerje ose ndodh situata e pamundësisë së shlyerjes nga pjesëmarrësi me detyrimin më të lartë kontraktor.

2. Rreziku i tregut menaxhohet nëpërmjet karakteristikave të mëposhtme të sistemit:

a) Pjesëmarrësve që tregtojnë në blerje të titullit u jepet mundësia që të vendosin limit kohor, për të cilin instruksionet duhet të përputhen që më tej të hyjnë në procesin e shlyerjes. Nëpërmjet këtij shërbimi, blerësi merr informacion paraprak për ecurinë e procesit të shlyerjes së titullit në kohën e përcaktuar nga ai, duke pasur kështu mundësinë e vendimmarrjes në lidhje me vazhdimin ose jo të transaksionit;

b) Përcaktimi sipas pikës 1, shkronja “b” e këtij neni.

3. Rreziku i likuiditetit menaxhohet nëpërmjet karakteristikave të mëposhtme të sistemit:

a) Jepet mundësia që pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë të vendosin një nivel tavan për përdorimin e llogarisë së tij në sistemin AIPS nga pjesëmarrës të tjerë për të cilët ky pjesëmarrës luan rolin e agentit shlyerës në sistemin AIPS. Ky tavan është i ndryshueshëm gjatë ditës, sipas përshkrimit në manualin e përdorimit;

b) Përcaktimi sipas pikës 1, shkronja “b” e këtij neni.

4. Rreziku operacional menaxhohet nëpërmjet karakteristikave të mëposhtme:

a) Aplikimit të parimit të katër syve, përmes të cilit çdo e dhënë e re e hedhur në sistem do të duhet të aprovohet nga një përdorues i sistemit i ndryshëm nga hedhësi i të dhënës;

b) Aplikimit të procedurave Fallback-Recovery sipas përcaktimit të rregullores së Bankës së Shqipërisë “Për Sigurinë e Informacionit”;

c) Përditësimit të vazhdueshëm të bazës rregullative që menaxhon sistemin.

Neni 10

Modelet e parimit DVP

1. Sistemi është i bazuar në modelet e mëposhtme DVP:

a) Modelin DVP 2 për shlyerjen e transaksioneve të tregut primar;

b) Modelin DVP 1 për shlyerjen e çdo transaksioni tjetër, përveç atyre të përcaktuara në shkronjën “a”.

2. Në rastin e transaksioneve në ALL dhe transaksioneve të tregut primar në monedhë të huaj shlyerja bëhet në kohë reale nëpërmjet sistemit AIPS dhe sistemit LORO respektivisht.

3. Në rastin e transaksioneve në tregun sekondar në valutë, shlyerja e titujve ndodh pas konfirmimit të shitësit për marrjen e fondeve sipas përcaktimit në nenin 33, pika 4.

Neni 11

Realizimi i parimit DVP

Parimi DVP në sistemin AFISaR realizohet nëpërmjet hapave të mëposhtëm:

1. Verifikimi i vlefshmërisë së mesazheve të dërguara nga pjesëmarrësit: çdo instruksion pagese i mbërritur në këtë sistem do t’i nënshtrohet verifikimit të vlefshmërisë, i cili



përfshin kontrollimin e formateve të fushave (sintaksa), përmbajtjen e tyre dhe lidhjet mes tyre (konteksti). Mesazhet që përmbajnë gabime refuzohen dhe çdo pjesëmarrës njoftohet për arsyen(t) e refuzimit sipas mesazhit të përshkruar në Shtojcën 6;

2. Përputhja e mesazheve të dërguara nga pjesëmarrësit: ky është procesi nëpërmjet të cilit identifikohen instruksionet përbërëse të një transaksioni dhe më pas bëhet krahasimi midis instruksionit të dërguar nga pjesëmarrësi në transaksion dhe instruksionit të dërguar nga kundërpala e tij, për të siguruar që termat e transaksionit janë identike në të dyja instruksionet. Fushat dhe të dhënat që krahasohen janë të përshkruara në shtojcën 6. Sistemi nuk ofron asnjë hapësirë tolerance. Të gjithë instruksionet që kërkojnë njoftim dypalësh që kanë kaluar hapin e verifikimit si të vlefshme, i nënshtrohen procesit të përputhjes;

3. Pranimi i instruksioneve: pas plotësimit të përputhshmërisë, sistemi i pranon instruksionet duke gjeneruar një kod unik për transaksionin. Momenti i pranimit është momenti i hyrjes së pagesës në sistemin AFISaR;

4. Rezervimi i titujve: në rast se titujt janë në llogarinë e shitësit, atëherë ato rezervohen për këtë transaksion dhe shitësi nuk mund t'i tregtojë më. Në rast se ato nuk janë të gatshme në llogarinë e shitësit, atëherë transaksioni vendoset në radhë "Pritje për titullin", sipas përcaktimit në Shtojcën 5;

5. Shlyerja e transaksioneve: pas konfirmimit të shlyerjes së fondeve nga:

- a) AIPS për operacionet në monedhën vendase,
- b) Loro për operacionet e tregut primar në monedhë të huaj,
- c) Shitësi për operacionet e tregut sekondar në monedhë të huaj,

sistemi pranon shlyerjen e operacionit përkatës, duke e bërë shlyerjen e pakthyeshme dhe procedon me transferimin e pronësisë së instrumentit financiar ose regjistrimin e titullit si kolateral në rastin e marrëveshjeve të kolateralit financiar, duke përfunduar kështu shlyerjen e tyre. Në rast të mungesës së konfirmimit nga burimet e përcaktuara në pikën 5, si rezultat i mungesës së fondeve, transaksionet qëndrojnë në radhë "Pritje për konfirmimin e fondeve" deri në

DVP cut-off të ditëvalutës së shlyerjes. Në rast se transaksioni nuk është shlyer deri në DVP cut-off të ditëvalutës së shlyerjes, atëherë ai anulohet;

6. Konfirmimi i transaksioneve: kur përfundon shlyerja e transaksionit, sistemi u dërgon pjesëmarrësve njoftime për të konfirmuar atë. Në rast të anulimit të transaksionit, sistemi dërgon njoftime për pjesëmarrësit. Njoftimet bëhen sipas përshkrimit në shtojcën 6.

KREU III

ROLI I ADMINISTRATORIT

Neni 12

Detyrat në funksion të rregullimit dhe organizimit të Sistemit

Administratori në funksion të organizimit dhe rregullimit të Sistemit AFISaR, kryen detyrat e mëposhtme:

a) miraton rregullat e nevojshme për të siguruar mirëfunksionimin dhe sigurinë e sistemit AFISaR;

b) pranon pjesëmarrës të rinj të drejtpërdrejtë në sistemin AFISaR, dhe/ose ndryshon statusin apo informacionin për pjesëmarrësit në këtë sistem, sipas rregullave të përcaktuara;

c) nënshkruan kontratën tip të pjesëmarrjes me pjesëmarrësit e sistemit AFISaR;

d) ndërton mekanizma për mbulimin e nevojave për likuiditet, me qëllim sigurimin e shlyerjes së instruksioneve të pagesës të dërguara nga pjesëmarrësit e lejuar për përdorimin e këtij mekanizmi;

e) vendos për kufizimin e përkohshëm të aksesit në sistem dhe përjashtimin e një pjesëmarrësi të drejtpërdrejtë në sistem; dhe

f) siguron zhvillimin dhe mbikëqyrjen e sistemit AFISaR, në përputhje me standardet ndërkombëtare të fushës.

Neni 13

Detyrat në funksion të administrimit dhe operimit të Sistemit

Administratori në funksionin e administrimit dhe operimit të Sistemit AFISaR, kryen detyrat e mëposhtme:

a) mban dhe menaxhon llogaritë e pjesëmarrësve në sistem;

b) siguron në kohë reale dhe të pakthyeshme shlyerjen përfundimtare të pagesave të



pjesëmarrësve, të cilat plotësojnë kushtet e mjaftueshmërisë së fondeve dhe/ose të titujve;

c) merr të gjitha masat e nevojshme dhe të arsyeshme për të siguruar menaxhimin e duhur dhe mbajtjen e të dhënave për të mbrojtur të drejtat që burojnë nga pronësia e titujve për investitorët, të cilët kanë llogari në sistem dhe nuk janë pjesë e llogarive omnibus;

d) imponon dhe zbaton të gjitha procedurat e nevojshme, në mënyrë që të sigurojë ruajtjen dhe mbajtjen e të dhënave të titujve në llogari të pjesëmarrësve, nëpërmjet rakordimit të të dhënave me pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë;

e) mban sistemin në gjendje pune, duke u lejuar pjesëmarrësve akses në sistem, në përputhje me orët e punës së sistemit, si dhe me dispozitat e kësaj rregulloreje;

f) përcakton plane emergjence, të cilat sigurojnë përmbushjen në kohë të proceseve ditore të sistemit, në rrethana të paparashikuara;

g) u mundëson pjesëmarrësve të drejtpërdrejtë akses të barabartë, duke u bazuar në mekanizma të sigurt për mbrojtjen e aksesit ndaj tij, për autentifikimin e dërguesit të instruksionit, për mbrojtjen e besueshmërisë dhe të konfidencialitetit të informacionit të marrë dhe të ruajtur nga AFISaR;

h) përcakton procedurat ditore të hapje-mbylljes, arkivimit dhe backup-it të sistemit;

i) përcakton orët operuese të sistemit AFISaR dhe në rast ndryshimesh, njofton menjëherë pjesëmarrësit;

j) përcakton përfshirjen e pjesëmarrësve të drejtpërdrejtë në sistem dhe kryen procedurat e anëtarësimit dhe certifikimit të një pjesëmarrësi të ri në sistem;

k) në bashkëpunim të ngushtë me ofruesit e hardware/software, korrigjon pa vonesë çdo gabim apo dështim në sistem;

l) administron sigurinë e sistemit në përputhje me rregulloren e Bankës së Shqipërisë “Për Sigurinë e Informacionit”;

m) monitoron sistemin AFISaR dhe veçanërisht:

- i) gjendjen funksionale të sistemit,
- ii) shlyerjen e transaksioneve,
- iii) ndërfaqet e AFISaR me sistemet e tjera,
- iv) gjendjen e lidhjes së internetit,
- v) instruksioneve e pagesave të kryera nga/për një llogari,

vi) urdhër në pritje në radhën e një pjesëmarrësi;

n) pezullon funksionimin e sistemit AFISaR sipas procedurave të parashikuara në nenin 74 të kësaj rregulloreje;

o) mban rekorde të transaksioneve dhe të dhënave në përputhje me legjislacionin në fuqi;

p) ofron trajnime dhe asistencë teknike për pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë, të cilët aksesojnë sistemin sipas nenit 44;

q) mban tatimin në burim mbi aktivitetin me titujt nga sistemi AFISaR. Ky detyrim përcaktohet nga Ministria e Financave (Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve) dhe reflektohet në sistem nga administratori. Pjesëmarrësi mund të përditësojë në çdo rast dokumentin e përcaktuar në nenin 18, pika 1, shkronja “d”, të kësaj rregulloreje, në rast se ka ndryshime legjislative /rregullatore.

Neni 14

Përgjegjësitë e administratorit

1. Administratori është përgjegjës për dështimet e sistemit AFISaR dhe këto të kufizuara deri në gabimet në operacionet që regjistrohen nga vetë administratori.

2. Administratori nuk është përgjegjës për rastet e mëposhtme:

a) dështimin e sistemit AFISaR që rezulton nga përdorimi jokorrekt i tij nga pjesëmarrësit;

b) dëmet që shkakton dështimi i sistemit AFISaR që rezulton nga një problem i software-it;

c) dëmet e shkaktuara nga instruksionet e gabuara të pjesëmarrësve apo nga gabime të instruksioneve, të cilat nuk janë kriter i përcaktuar për vlerësimin e vlefshmërisë së instruksioneve;

d) dëmet e shkaktuara nga mosushtrimi i përgjegjësisë së pjesëmarrjeve për monitorimin e llogarisë së tyre sipas nenit 44, pika 2, shkronja c;

e) kapacitetin për të vepruar dhe gjendjen financiare të emetuesit në të gjitha operacionet që emetuesi është palë;

f) mundësinë që transferimi i titullit që kryhet nga një pjesëmarrës të shpallet më pas i pavlefshëm ose pa efekte ligjore, pavarësisht se është regjistruar në sistem në përputhje me këto rregulla;



g) mundësinë që garancia e vendosur nëpërmjet regjistrimit të kolateralit financiar në përputhje me këto rregulla, të shpallet e pavlefshme ose pa efekte ligjore;

h) mundësinë që kreditori mund të mos ekzekutojë kolateralin nëpërmjet përvetësimit ose shitjes për shkak të pengesave që ndodhin jashtë kontrollit të sistemit dhe administratorit të tij;

i) sigurinë, cilësinë dhe disponueshmërinë e shërbimeve të ofruara nga kompania SWIFT.

KREU IV

PJESËMARRJA NË SISTEMIN AFISAR

Neni 15

Kategoritë e pjesëmarrësve

1. Pjesëmarrësit në sistemin AFISaR kategorizohen në:

a) Pjesëmarrës të drejtpërdrejtë, të cilët mund të dërgojnë vetë instruksione shlyerje për llogari të tyre apo të klientëve të tyre, përmes aksesit në sistem nëpërmjet VPN ose nëpërmjet SWIFT-it. Në këtë kategori përfshihen:

i) Banka e Shqipërisë;

ii) bankat në Shqipëri;

iii) shoqëritë komisionere rezidente ose jorezidente;

iv) institucione financiare rezidente (të ndryshme nga bankat) dhe institucione financiare jorezidente,

v) depozitarë qendrorë jorezidentë;

vi) shtëpitë e klerimit të titujve;

vii) bursa e titujve;

viii) Ministria e Financave;

b) Pjesëmarrës të tërthortë, për të cilët llogaritë në sistemin AFISaR hapen nga pjesëmarrës të drejtpërdrejtë. Këta mund të organizohen në llogari omnibus, ose mund të kenë llogari individuale, sipas përcaktimit në nenin 26. Në këtë kategori përfshihen:

i) personat fizikë; dhe

ii) personat juridikë;

2. Pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë në sistem, mund të kryejnë një ose më shumë prej kapaciteteve të mëposhtme:

a) emetues, duke nënkuptuar kapacitetin për shitjen e titujve në tregun primar. Këtë kapacitet do ta ketë Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë;

b) bankë qendrore. Këtë kapacitet do ta ketë Banka e Shqipërisë;

c) kujdestarë, duke nënkuptuar kapacitetin që pjesëmarrësit të kryejnë transaksione për llogaritë e tyre, si edhe për llogaritë e klientëve të tyre. Këtë kapacitet do ta ketë Banka e Shqipërisë dhe të gjithë pjesëmarrësit që janë të licencuar nga autoritetet përkatëse për të kryer veprime në emër të klientëve të tyre. Në mungesë të këtij kapaciteti, pjesëmarrësit kryejnë transaksione vetëm për llogaritë e tyre;

d) pjesëmarrës në tregun primar, duke nënkuptuar kapacitetin për të vendosur kërkesa në tregun primar në mënyrë të drejtpërdrejtë, për llogari të tyre apo të klientëve të tyre. Këtë kapacitet do ta kenë të gjithë pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë. Ministria e Financave ka të drejtë të përcaktojë kufizime për pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë në tregun primar;

e) agjent shlyerës, duke nënkuptuar kapacitetin për të shlyer direkt në sistemin AIPS pagesat që rrjedhin nga transaksionet me tituj. Këtë kapacitet e kanë të gjithë pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë në sistemin AIPS dhe në sistemin loro, vetëm për shlyerjen e veprimeve të tregut primar.

3. Pjesëmarrësi ka të drejtë të kërkojë ndryshimin e një ose më shumë prej kapaciteteve të mësipërme. Ndryshimi prodhon efekte mbi llogaritë e hapura për pjesëmarrësin.

Neni 16

Pjesëmarrja e Bankës së Shqipërisë

1. Banka e Shqipërisë merr pjesë në sistem si pjesëmarrës i drejtpërdrejtë për llogari të saj.

2. Banka e Shqipërisë mund të hapë llogari për klientë të saj që kanë statusin e mëposhtëm:

a) persona fizikë që marrin pjesë në ankandet primare nëpërmjet sporteleve të saj të hapura për këtë qëllim;

b) fondin e pensionit të punonjësve të saj;

c) persona juridikë që nënshkruajnë kontratë me të për pjesëmarrjen e tërthortë.

Neni 17

Mënyrat e lidhjes

Mënyrat e lidhjes së pjesëmarrësve me sistemin AFISaR përcaktohen në nenet 44 dhe 45.



Neni 18

Kushtet për pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë

1. Institucionet që kërkojnë pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) të kenë nënshkruar kontratën tip të pjesëmarrjes të drejtpërdrejtë në sistemin AFISaR me administratorin sipas shtojcës 1, me përjashtim të Bankës së Shqipërisë;

b) të marrin pjesë në sistemin AFISaR vetëm nëpërmjet drejtorive të tyre;

c) çdo kandidat për pjesëmarrje të drejtpërdrejtë duhet të plotësojë të paktën një nga mënyrat e lidhjes të përcaktuara në nenet 44 dhe 45;

d) të paraqesin një vërtetim nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në lidhje me skemën e tatimit për të ardhurat nga investimi në tituj;

e) të ketë llogari shlyerëse në sistemin AIPS, ose të ketë lidhur kontratë me një agjent shlyerës në këtë sistem.

2. Përveç kushteve të përmendura në pikën 1, pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë që do kërkojnë aksesimin e sistemit të AFISaR nëpërmjet VPN, duhet të plotësojnë edhe kushtet e mëposhtme:

a) të kenë hartuar rregulla të brendshme operimi për sistemin AFISaR, sipas udhëzimeve të administratorit;

b) të kenë personel të kualifikuar dhe të trajnuar për operimin në sistemin AFISaR;

c) të kenë marrë nga administratori certifikatën e pjesëmarrjes në sistemin AFISaR.

3. Përveç kushteve të përmendura në pikën 1, pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë që do aksesojnë sistemin nëpërmjet SWIFT duhet të jenë të regjistruar në sistemin SWIFT dhe të kenë akses në shërbimin SWIFTNet FIN.

4. Përveç kushteve të përmendura në pikën 1, institucionet, të cilët rregullohen nga legjislacioni i një shteti tjetër, dhe kërkojnë të jenë pjesëmarrës të drejtpërdrejtë, duhet të dorëzojnë edhe dokumentet zyrtare të mëposhtme:

a) vërtetim mbi statusin e regjistrimit të personit juridik në regjistra të mbajtur për këtë qëllim, sipas përcaktimeve të shtetit të origjinës;

b) vërtetim mbi gjendjen financiare të personit juridik, që të vërtetojë aftësinë paguese të tij;

c) vërtetim që personi juridik nuk i është nënshtruar procedurave të falimentimit bazuar në

legjislacionin përkatës të vendit të origjinës;

d) vërtetim nga institucionet përkatëse për vlefshmërinë e lejeve/licencave/autorizimeve të lëshuara për të legjitimuar aktivitetet financiare që parashikojnë të kryejnë;

e) dokumenti provues që autorizon kryerjen e veprimeve financiare në emër dhe për llogari të personit juridik;

f) çdo dokument tjetër të nevojshëm sipas legjislacionit të vendit të origjinës, që i nevojitet për ushtrimin e aktivitetit, apo që rrjedh si detyrim nga ushtrimi i aktivitetit.

5. Dokumentet e përcaktuara në pikën 4, dhe çdo dokument tjetër që dorëzohet nga personi juridik i huaj, paraqiten të legalizuara sipas marrëveshjeve në të cilat Republika e Shqipërisë është palë, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të njehsuara me origjinalin sipas përcaktimeve ligjore.

6. Përveç kushteve të përmendura në pikën 1, 2, 3 dhe 4, administratori mund të vendosë kërkesa në lidhje me shëndetin financiar, apo të tjera, të pjesëmarrësve para anëtarësimit si dhe gjatë pjesëmarrjes.

Neni 19

Pjesëmarrja e tërthortë

Pjesëmarrja e tërthortë në sistem mund të ndodhë nëpërmjet mënyrave të mëposhtme:

a) me llogari individuale;

b) me llogari të përbashkët (llogari omnibus).

Neni 20

Kushtet për pjesëmarrjen e tërthortë

1. Pranimi si pjesëmarrës i tërthortë me llogari individuale bëhet vetëm nga Banka e Shqipërisë për pjesëmarrësit me të cilët ajo nënshkruan kontratën për pjesëmarrjen e tërthortë ose me miratimin e saj për klientët e pjesëmarrësve të tjerë të drejtpërdrejtë.

2. Pranimi i pjesëmarrjes së tërthortë me llogari të përbashkët (llogari omnibus) bëhet nëpërmjet pjesëmarrësve të drejtpërdrejtë të cilët kanë në sistemin AFISaR kapacitetin e kujdestarit sipas nenit 15, pika 2, shkronja “c”.

3. Një person juridik mund të bëhet pjesëmarrës i tërthortë me llogari individuale kur plotëson kushtet e mëposhtme:

a) të jetë pjesëmarrës i tërthortë në sistemin AIPS ose të ketë lidhur kontratë me një agjent shlyerës për shlyerjen e veprimeve me tituj;



b) të ketë nënshkruar kontratën tip të pjesëmarrjes së tërthortë të personave juridik në sistemin AFISaR, sipas shtojcës 2.

4. Një person fizik mund të bëhet pjesëmarrës i tërthortë me llogari individuale kur plotëson kushtet e mëposhtme:

a) të ketë një llogari fondesh për shlyerjen e veprimeve me tituj të hapur me një nga agjentët shlyerës me të cilët Banka e Shqipërisë ka lidhur marrëveshje për shlyerjen e veprimeve me tituj të personave fizikë klientë të saj, sipas shtojcës 4;

b) të ketë nënshkruar kontratën tip të pjesëmarrjes së tërthortë të personave fizikë në sistemin AFISaR, sipas shtojcës 3.

Neni 21

Procedura për anëtarësim e pjesëmarrësve të drejtpërdrejtë në sistemin AFISaR nëpërmjet VPN-së

Procedura për anëtarësim si pjesëmarrës i drejtpërdrejtë me të drejtë aksesimi i sistemit AFISaR nëpërmjet VPN, kalon nëpër këta hapa:

a) kandidati për pjesëmarrës i drejtpërdrejtë i paraqet administratorit një kërkesë me shkrim për anëtarësimin e tij në sistemin AFISaR, bashkë me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm që vërteton plotësimin e kushteve të përcaktuara në nenin 15, pika 1, shkronja “a” dhe pika 2 shkronjat “c” deri në “f”.

b) administratori shqyrton kërkesën e kandidatit për anëtarësim dhe i kthen përgjigje brenda 10 (dhjetë) ditësh pune nga data e marrjes së kërkesës;

c) në rast të miratimit të kërkesës, administratori, informon pjesëmarrësin për plotësimin e kushteve të përcaktuara në nenin 18, duke i vënë në dispozicion të gjithë bazën rregullative;

d) administratori në bashkëpunim me kandidatin, përcaktojnë dhe zbatojnë kalendarin e anëtarësimit si në shtojcën 10;

e) administratori trajnon përdoruesit e ardhshëm të kandidatit dhe drejton testimin për certifikimin e kandidatit;

f) pas përfundimit me sukses të provave dhe pasi sigurohet për përputhshmërinë e rregullave të brendshëm të kandidatit me këtë rregullore, lëshon një certifikatë për kandidatin si pjesëmarrës në sistemin AFISaR;

g) kandidati për pjesëmarrës plotëson formularët në shtojcën 13;

h) kandidati për pjesëmarrës, nënshkruan kontratën tip të pjesëmarrjes në sistemin AFISaR, me administratorin e sistemit, sipas shtojcës 1;

i) administratori kryen veprimet e tij për krijimin e përdoruesve në sistemin AFISaR, VPN, Firewall përgatitjen e certifikatave të sigurisë, si dhe dorëzimin e pajisjeve të sigurisë pjesëmarrësit;

j) administratori njofton pjesëmarrësin për datën që do t’i jepet akses në sistemin AFISaR të paktën 5 (pesë) ditë punë përpara kësaj date;

k) Administratori njofton të gjithë pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë të sistemit AFISaR për emrin, adresën e saktë (kodin BIC) të pjesëmarrësit të ri, si dhe për datën në të cilën pjesëmarrësit në fjalë do t’i jepet akses në sistemin AFISaR, 5 (pesë) ditë pune para kësaj date.

Neni 22

Procedura për anëtarësim e pjesëmarrësve të drejtpërdrejtë në sistemin AFISaR nëpërmjet SWIFT-it

Procedura për anëtarësim si pjesëmarrës i drejtpërdrejtë me të drejtë aksesimin e sistemit AFISaR nëpërmjet SWIFT-it përfshin:

a) të gjitha hapat e përshkruar në nenin 21, shkronjat “a”, “b”, “c”, “d”, “g”, “h”, “j”, “k”;

b) shkëmbimin e autorizimeve RMA.

Neni 23

Kufizimi i përkohshëm në sistemin AFISaR i një pjesëmarrësi të drejtpërdrejtë

1. Administratori ka të drejtë të kufizojë përkohësisht një pjesëmarrës të drejtpërdrejtë në sistemin AFISaR.

2. Administratori vendos kufizime mbi llogaritë e pjesëmarrësit në rastet e mëposhtme:

a) me njoftim zyrtar të autoritetit përkatës për kufizimin e përkohshëm të licencës për të kryer veprime me titujt në emër të vetë pjesëmarrësit apo për llogari të klientëve të tij;

b) me kërkesë zyrtare nga autoriteti përkatës ose nga prokuroria/gjykata për kufizimin e përkohshëm të llogarive të pjesëmarrësit;

c) pjesëmarrësi i drejtpërdrejtë dështon në plotësimin e qoftë dhe njërit prej kushteve të përcaktuara në nenet 18, dhe 25;



d) kanë filluar procedurat e likuidimit;

e) pjesëmarrësi dështon në zbatimin e kësaj rregulloreje në mënyrë të pajustificuar dhe/ose për më shumë se 3 (tri) ditë pune;

f) vendosjen e ndonjë embargoje kundrejt shtetit në të cilin ka rezidencën pjesëmarrësi;

g) me kërkesë me shkrim të vetë pjesëmarrësit dhe me miratimin e saj nga administratori;

h) kur pjesëmarrësi plotëson kushtet për përjashtim, por përjashtimi është e pamundur të kryet, për shkak të mosplotësimit të kushtit të përcaktuar në nenin 24 pika 2.

3. Pjesëmarrësi i kufizuar përkohësisht ka detyrimin të vazhdojë të përmbushë detyrimet e veta financiare dhe jo vetëm, në përputhje me përcaktimet në këtë rregullore.

4. Kufizimi i pjesëmarrjes së përkohshme bëhet nëpërmjet kufizimit të llogarisë/llogarive të pjesëmarrësit. Pjesëmarrësi mund të kryejë veprime me këto llogari vetëm me aprovim të arsyetuar të autoritetit përkatës.

5. Administratori vendos shfuqizimin /revokimin e kufizimit të përkohshëm kur pjesëmarrësi ka përmbushur detyrimet e kërkuara për të përfunduar kufizimin dhe/ose autoritetet përkatëse të cilat kanë marrë vendimin për kufizimin e përkohshëm, njoftojnë për përfundimin e nevojës për kufizim.

6. Administratori njofton menjëherë për vendimin për kufizim të përkohshëm të aksesit të një pjesëmarrësi ose shfuqizimin/revokimin e këtij vendimi vetë pjesëmarrësin dhe pjesëmarrësit e tjerë.

Neni 24

Përjashtimi i një pjesëmarrësi të drejtpërdrejtë nga sistemi AFISaR

1. Administratori vendos për përjashtimin e një pjesëmarrësi të drejtpërdrejtë nga sistemi AFISaR, kur plotësohet të paktën njëra nga rrethanat e mëposhtme:

a) me kërkesë me shkrim të vetë pjesëmarrësit, menjëherë pas miratimit nga administratori të kërkesës;

b) pjesëmarrësi bashkohet/përthithet me/nga një /disa pjesëmarrës të tjerë;

c) administratorit i komunikohet vendimi për likuidimin /paaftësinë paguese, apo në rastet kur vendimi për heqjen e licencës nga autoriteti përkatës është përfundimtar dhe i parevokueshëm;

d) pjesëmarrësi shkel në mënyrë të përsëritur dispozitat e kësaj rregulloreje. Në këtë rast, administratori duhet të sigurohet që pjesëmarrësit i është dhënë mundësia të shprehë mendimin e tij.

2. Përpara kryerjes së procedurës së përjashtimit të pjesëmarrësit, administratori sigurohet që llogaria e pjesëmarrësit dhe e klientëve të tij janë me gjendje zero dhe nuk ka pagesa në hyrje apo në dalje nga llogaria e tij apo e klientëve të tij.

3. Në rast se përjashtimi i pjesëmarrësit është i pamundur për shkak të gjendjes në llogarinë e tij/të klientëve të tij, pjesëmarrësi kufizohet përkohësisht, deri sa të kryhen procedurat për transferimin e gjendjes së llogarive të tij.

4. Administratori njofton menjëherë për vendimin për përjashtimin e një pjesëmarrësi, vetë pjesëmarrësin dhe pjesëmarrësit e tjerë.

5. Administratori mbyll llogarinë e pjesëmarrësit të përjashtuar. Të dhënat historike për këtë pjesëmarrës mbeten në databazë.

6. Pjesëmarrësi është i detyruar të paguajë të gjitha detyrimet ndaj administratorit për pjesëmarrjen në sistem, që kanë lindur përpara vendimit për përjashtimin e tij.

7. Administratori kryen procedurat e përcaktuara për ndërprerjen e lidhjes me pjesëmarrësin duke ç'aktivizuar certifikatën dhe/ose revokuar autorizimin RMA.

Neni 25

Detyrimet e pjesëmarrësve të drejtpërdrejtë në sistemin AFISaR

1. Pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë të sistemit AFISaR janë të detyruar:

a) Të zbatojnë rregullat dhe procedurat e sistemit AFISaR;

b) Të kanalizojnë instruksionet e pagesave në sistemin AFISaR, vetëm mbi bazën e një dokumenti të vlefshëm justifikues;

c) Të kanalizojnë instruksionet e pagesave në sistemin AFISaR, vetëm nga personat e autorizuar;

d) Të administrojnë sistemet e tij lokale, për të siguruar vazhdimësinë dhe dërgimin e instruksioneve të pagesave në sistemin AFISaR;

e) Të ruajnë regjistrimet e transaksioneve në kopje letër për një periudhë jo më pak se 10 (dhjetë) vjet dhe në format elektronik, sipas



standardeve dhe rregullave kontabël në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

2. Krahas detyrimeve të shprehura në pikën 1 të këtij neni, pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë të cilët e aksesojnë sistemin nëpërmjet VPN, janë të detyruar të:

a) të aksesojnë sistemin AFISaR në çdo kohë gjatë ditës së operimit, duke respektuar oraret e tij të punës sipas shtojcës 4;

b) të sigurojnë personel të kualifikuar, të autorizuar për operim në sistemin AFISaR;

c) të mos lejojnë personelin e përkohshëm apo të jashtëm të operojë në sistemin AFISaR;

d) të njoftojnë administratorin në rast të lëvizjes së personelit që ka operuar në sistemin AFISaR, për anulimin e certifikatës së këtij përdoruesi;

e) të hartojnë procedura të brendshme për sigurinë dhe për mbrojtjen e sistemit, duke përfshirë procedurat organizative (burimet njerëzore dhe pajisjet) dhe ato informatike (elementet hardware dhe software), në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje;

f) të sigurojnë integritetin e transaksioneve dhe akseseve të përdoruesve brenda institucioneve përkatëse, duke:

i) lokalizuar çdo pikë lidhjeje primare apo backup në sistemin AFISaR, vetëm aty ku ka akses të përshtatshëm për mjetet dixhitale të telekomunikimit, për konfigurimet e duhura të autenticitetit dhe të mjeteve të sigurisë, si dhe të ekzistojë siguria që funksionimi i sistemit AFISaR nuk do të jetë subjekt i ndërprerjeve apo i ndërhyrjeve të shkaktuara nga faktorët e brendshëm apo të jashtëm;

ii) zbatuar parimin “katër sytë” për autorizimin e urdhërpagesës, duke siguruar përdorues të ndryshëm për hedhje të dhënash dhe aprovim të tyre;

iii) kryer ekzekutimin e instruksioneve të pagesës, sipas procedurave që respektojnë të drejtat minimale në përputhje me rolin dhe përgjegjësitë e kategorive të ndryshme të personelit;

iv) u bërë subjekt kontrolli nga auditi i brendshëm apo personeli mbikëqyrës për çdo instruksion të refuzuar, të korigjuar, anuluar apo e fshirë;

v) kryer vlerësime periodike mujore mbi ngjarjet e paparashikuara në sistemin AFISaR,

sipas Shtojcës 16 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje, dhe t'i dërgojnë zyrtarisht pranë administratorit, çdo muaj;

vi) raportuar çdo muaj janar pranë administratorit për çdo shkelje të vërejtur apo të dyshuar të sigurisë, si dhe të integritetit dhe të qëndrueshmërisë së pajisjeve të tyre të brendshme që lidhen me sistemin AFISaR, sipas Shtojcës 15 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje;

vii) hartuar një plan emergjence, i cili garanton përmbushjen në kohë të veprimeve ditore të sistemit AFISaR në rrethana të paparashikuara.

3. Në rast shkeljeje të detyrimeve të mësipërme, informohet autoriteti përkatës, si dhe pjesëmarrësi, të cilit i bëhen të ditura edhe pasojat sipas përcaktimit në nenin 23.

Neni 26

Llogaritë e titujve të pjesëmarrësve

1. Administratori hap ose miraton hapjen e llogarive të titujve për pjesëmarrësit në sistemin AFISaR. Llogaritë pranojnë veprime në debi dhe në kredi.

2. Në sistemin AFISaR mund të hapen llojet e mëposhtme të llogarive të titujve:

a) llogaria vetjake (0) që është llogaria e hapur në emër të pjesëmarrësit, në të cilën depozitohen titujt e zotëruar nga vetë pjesëmarrësi;

b) llogaria omnibus (1) që është llogaria e hapur në emër të pjesëmarrësit dhe ku depozitohen titujt e zotëruar nga klientët e pjesëmarrësit që mund të jenë persona fizikë ose juridikë, rezidentë ose jorezidentë. Llogaria omnibus mund të ketë si rregull kategoritë e mëposhtme, të cilat mund të shtohen/ndryshohen në marrëveshje midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave:

i) llogari omnibus për persona fizikë,

ii) llogari omnibus për shoqëri tregtare,

iii) llogari omnibus për fonde pensioni;

c) llogari individuale është llogaria e hapur nga pjesëmarrësi i drejtpërdrejtë, ku depozitohen titujt për një klient të vetëm, që mund të jetë person fizik ose juridik, rezident ose jorezident, të dhënat identifikuese të të cilit janë hedhur paraprakisht në sistemin AFISaR;

d) llogaria e nivelit tavan të tregtimit që është llogaria në emër të një pjesëmarrësi të sistemit



AFISaR por që nuk është një pjesëmarrës direkt ose i tërthortë në sistemin AIPS, e për rrjedhojë do përdorë llogarinë e një pjesëmarrësi tjetër që është agjent shlyerës në sistemin AIPS;

e) llogaria e emetuesit (9) që është llogari e hapur në emër të emetuesit, në të cilën depozitohen titujt e emetuar prej tij.

KREU V

OPERACIONET ME TITUJ NË SISTEMIN AFISAR

Neni 27

Transaksionet me tituj në tregun primar

1. Ankandet e tregut primar për emetimin e titujve të Shtetit Shqiptar do të kryhen nëpërmjet sistemit AFISaR. Mënyra si përdoret sistemi AFISaR për të paraqitur kërkesat për ankand është e përshkruar në Manualin e Përdorimit, ndërsa rregullat e tjera që kanë lidhje me ankandin në tregun primar apo operacione të tjera të emetuesit sipas përshkrimit në nenet 29 deri 31, janë të përcaktuara në marrëveshjen përkatëse midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave.

2. Pjesëmarrja në ankand gjeneron detyrimin e pjesëmarrësit në sistem për të shlyer transaksionet që gjenerohen nga kjo pjesëmarrje, për llogari të vet pjesëmarrësit apo për llogari të klientëve që ai përfaqëson.

3. Shlyerja e transaksioneve të tregut primar do të bëhet sipas modelit DVP 2, ku titujt do të kalojnë në bazë bruto (transaksion për transaksion) nga llogaria e emetuesit në llogarinë e pjesëmarrësve që kanë rezultuar fitues në ankand në rastin e emetimit dhe nga llogaria e pjesëmarrësve në llogarinë e emetuesit në rastin e maturimit, i cili regjistrohet sipas pikës 4. Transaksionet e cash-it që gjenerohen nga këto dy ngjarje, do të netohen në një transaksion të vetëm sipas përcaktimit në pikën 5.

4. Në ditën e regjistrimit për maturimin e titujve, sistemi anulon të gjitha transaksionet që mund të jenë në proces për titullin përkatës që do maturohet, dhe e “pezullon” këtë titull nga tregtimet e mëtejshme.

5. Operacionet që do të netohen duhet të kenë të njëjtën datë shlyerje. Ato përfshijnë:

a) pagesat që gjenerohen nga maturimi i titujve;

b) pagesat që gjenerohen nga emetimi i titujve;

c) rihapjet e ankandëve në tregun primar.

6. Netimi i cash-it do të bëhet për çdo kategori llogarie që mund të ketë një pjesëmarrës sipas përshkrimit në nenin 26 , pika 2, me përjashtim të llogarive të përshkruara në shkronjën “d” të kësaj pike.

7. Rezultati i netimit mund të jetë një transaksion me kah kreditues ose me kah debitues. Në rast se nga rezultati i netimit të cash-it, gjenerohet një transaksion me kah debitues për agjentin shlyerës në sistemin përkatës sipas përcaktimit në pikën 12 të këtij neni, dhe ky i fundit nuk ka gjendje për të shlyer këtë transaksion, sistemi AFISaR do e mbajë këtë pozicion deri në përfundim të periudhës së faljes. Mbas kësaj periudhe pozicioni neto shpërbëhet në transaksionet individuale, duke kaluar në modelin DVP 1 të shlyerjes.

8. Në rast se transaksionet e gjeneruara sipas pikës 7, nuk shlyhen deri në datën e shlyerjes së përcaktuar në të dhënat e përgjithshme të ankandit, ato riciklohen çdo ditë deri në datën finale të shlyerjes.

9. Riciklimi sipas pikës 8, gjeneron komision i cili faturohet sipas përshkrimit në nenin 53.

10. Në rast të mos shlyerjes së transaksioneve si rezultat i pamjaftueshmërisë së fondeve në llogarinë e pjesëmarrësit ose të agjentit shlyerës deri në DVP cut-off të ditës përfundimtare të shlyerjes, transaksionet anulohen dhe titujt depozitohen në llogarinë vetjake të emetuesit.

11. Në rast të mos shlyerjes së transaksioneve si rezultat i pamjaftueshmërisë së fondeve në llogarinë e cash-it të emetuesit, titujt mbeten në llogarinë e pjesëmarrësit dhe riciklohen në pafundësi.

12. Transaksionet e tregut primar:

a) në monedhën vendase do të shlyen sipas përcaktimeve në këtë nen në sistemin e pagesave AIPS;

b) në monedhë të huaj do të do të shlyen sipas përcaktimeve në këtë nen në sistemin e llogarive në monedhë të huaj Loro.



Neni 28

Menaxhimi i pagesave që rrjedhin nga transaksionet në tregun primar

1. Pagesat e kuponave/interetit për titujt që kanë pagesa periodike të interesit, kryhen në ditën e pagesës të përcaktuar në të dhënat e përgjithshme të ankandit.

2. Pagesat e kuponave janë transferta FOD.

3. Pagesat totale të kuponave rakordohen me emetuesin.

4. Pas rakordimit, sistemi AFISaR llogarit shumat që u duhen paguar pjesëmarrësve, sipas gjendjes së tyre të titullit përkatës në ditën e regjistrimit, dhe dërgon instruksionin e pagesës në sistemin përkatës, sipas përcaktimit në nenin 27, pika 12.

5. Pas marrjes së konfirmimit për kryerjen e pagesës nga sistemi AIPS, AFISaR njofton pjesëmarrësit, sipas përshkrimit në Shtojcën 6.

Neni 29

Rihapja e ankandit

Procedurat për rihapjen e një ankandi në sistemin AFISaR janë njësoj si një ankand i ri.

Neni 30

Maturimet e parakohshme të emetuesit

1. Emetuesi ka të drejtë të bëjë thirrjen e titujve, duke bërë një maturim të parakohshëm të titujve, vetëm në rast se një gjë e tillë është parashikuar që në të dhënat e përgjithshme të ankandit ose në prospektin e titullit të regjistruar në sistemin AFISaR dhe data e maturimit të parakohshëm është përcaktuar në marrëveshje me të gjithë zotëruesit e titullit.

2. Emetuesi mund të iniciojë blerje të titullit përpara maturimit, duke kërkuar organizimin në sistemin AFISaR të ankandit për blerje të titullit përpara maturimit të titullit. Procesi i shlyerjes të transaksioneve të gjeneruara nga ky ankand është i ngjashëm me ato të një maturimi.

Neni 31

Marrëveshjet e riblerjes të emetuesit

Emetuesi ka të drejtë të bëjë marrëveshje riblerjeje dhe të anasjellta me pjesëmarrësit nëpërmjet sistemit AFISaR. Mund të zgjedhë të bëjë marrëveshje riblerje të veçantë ose duke kërkuar realizimin e një ankandi.

Neni 32

Transaksionet në tregun sekondar të titujve

Transaksionet në tregun sekondar midis pjesëmarrësve përfshijnë:

- transaksionet e shitblerjes;
- transfertat pa pagesë (FOP);
- marrëveshjet e riblerjes;
- marrëveshjet e huadhënies së titullit;
- marrëveshjet e kolateralit financiar.

Neni 33

Shitblerjet e titujve në tregun sekondar

1. Sistemi regjistron dhe shlyen shitblerjet e titujve në tregun sekondar të kryera midis:

- pjesëmarrësve të drejtpërdrejtë;
- një pjesëmarrësi të drejtpërdrejtë dhe klientëve të tij;
- pjesëmarrësit të drejtpërdrejtë dhe një pjesëmarrësi të tërthortë;
- pjesëmarrësit të drejtpërdrejtë dhe një klienti të një pjesëmarrësi tjetër të drejtpërdrejtë.

2. Transaksionet në tregun sekondar në ALL shlyhen në sistemin AFISaR sipas parimit dorëzim kundrejt pagesë, modeli DVP 1, duke ndjekur hapat e përshkruar në nenin 11.

3. Për pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë që përdorin për shlyerjen e transaksioneve në tregun sekondar të titujve në monedhën ALL një pjesëmarrës tjetër të drejtpërdrejtë në sistemin AFISaR që është agjent shlyerës në sistemin AIPS, shlyerja do të realizohet deri në nivelin e përcaktuar në llogarinë e tavanit të përcaktuar nga një marrëveshje midis pjesëmarrësit të drejtpërdrejtë dhe agjentit të tij shlyerës. Funkcionimi i tavanit shlyerës përshkruhet në Manualin e Përdorimit.

4. Transaksionet në tregun sekondar në monedhë të huaj midis pjesëmarrësve kur asnjë nga pjesëmarrësit nuk është Banka e Shqipërisë, shlyhen në sistemin AFISaR, duke respektuar hapat e mëposhtëm:

a) pas përfundimit të hapave të përshkruara në nenin 11, pikat 1 deri në 4, palët në transaksion marrin njoftim për kodin unik të gjeneruar dhe transaksioni vendoset në radhën “Pritje për konfirmimin e fondeve”;

b) për shlyerjen e transaksionit në sistemin AFISaR, pala shitëse në transaksion, pas marrjes së konfirmimit nga korrespondenti i saj për



hyrjen e fondeve, dërgon një njoftim në sistemin AFISaR, nëpërmjet mesazhit “Konfirmim kreditimi” sipas përshkrimit në Shtojcën 6, ku vendoset kodi unik i gjeneruar në sistemin AFISaR;

c) pas marrjes së konfirmimit të kreditimit, ndodh transferimi i titujve në AFISaR nga shitësi tek blerësi dhe shlyerja konsiderohet finale.

Sistemi e riciklon transaksionin deri në DVP cut-off të datës së valutës. Në qoftë se nuk është shlyer deri në DVP cut-off, transaksioni anulohet dhe titulli lirohet nga rezervimi i bërë sipas nenit 11 pika 4.

5. Transaksionet në tregun sekondar në monedhë të huaj kur njëra palë është Banka e Shqipërisë, sistemi AFISaR komunikon me sistemin Loro dhe “Konfirmimi i kreditimit” dërgohet automatikisht nga sistemi Loro në sistemin AFISaR.

6. Llojet e mesazheve SWIFT që shkëmbehen për shlyerjen e transaksioneve në tregun sekondar për titujt në monedhë vendase dhe të huaj, përcaktohen në Shtojcën 6.

Neni 34

Transfertat pa pagesë (FOP)

1. Transferata pa pagesë brenda sistemit AFISaR është transferata e titujve midis dy llogarive titujsh, e cila nuk gjeneron pagesë në sistemet e shlyerjes së fondeve me të cilët është i lidhur sistemi AFISaR.

2. Pjesëmarrësit mund të iniciojnë një transfertë pa pagesë në rastet e mëposhtme:

a) operacionet midis llogarisë vetjake të pjesëmarrësit të drejtpërdrejtë dhe llogarisë së një pjesëmarrësi të tërthortë, klient i të njëjtit pjesëmarrës të drejtpërdrejtë. Në këtë rast titujt transferohen midis llogarive të të njëjtit pjesëmarrës, dhe nuk prodhojnë transfertë fondesh, duke qenë se kanë të njëjtin pjesëmarrës në sistemin AIPS;

b) operacionet midis dy pjesëmarrësve që kanë të njëjtin agjent shlyerës në sistemin AIPS;

c) transferimi i titullit nga llogaria e klientit të një pjesëmarrësit të drejtpërdrejtë, në llogarinë e klientit në një pjesëmarrës tjetër të drejtpërdrejtë;

d) transferimet e titujve për shkak të bashkimit të pjesëmarrësve, apo rasteve të ndryshme të njohura dhe të konfirmuara nga autoriteti licencues dhe mbikëqyrës;

e) zëvendësimi i titujve të cilët janë tregtuar nëpërmjet marrëveshjeve të riblerjes dhe të kolateralit;

f) operacionet për transferimin e titujve për të plotësuar kërkesën për marzhin e ruajtjes së vlerës së titullit të tregtuar nëpërmjet marrëveshjeve të riblerjes.

3. Sistemi AFISaR inicion një transfertë pa pagesë në mënyrë automatike për transfertën e titujve nga llogaria e emetuesit (9) tek llogaria vetjake (0) e tij, në rastin e emetimit të ankandeve, dhe në drejtim të kundërt në rastin e maturimeve të parakohshme ose të rregullta.

4. Llojet e mesazheve SWIFT që shkëmbehen për shlyerjen e transaksioneve në tregun sekondar për titujt në monedhë vendase dhe të huaj përcaktohen në Shtojcën 6.

Neni 35

Marrëveshjet e riblerjes

1. Sistemi regjistron dhe shlyen marrëveshjet e riblerjes të lidhura midis:

a) pjesëmarrësve të drejtpërdrejtë për llogarinë e tyre vetjake;

b) pjesëmarrësit të drejtpërdrejtë për llogari të tij dhe klientit të tij që është pjesëmarrës i tërthortë me llogari individuale;

c) pjesëmarrësit të drejtpërdrejtë për llogari të tij dhe një pjesëmarrësi të tërthortë me llogari individuale në një pjesëmarrës tjetër të drejtpërdrejtë.

2. Marrëveshjet e riblerjes shlyhen sipas modelit DVP 1, përveç transaksioneve të përshkruara në pikën 1, shkronja “b”, të cilat janë transfertat FOP. Marrëveshjet e riblerjes përbëhen nga dy operacione në sistemin AFISaR, të cilat janë të lidhura me njëra-tjetrën:

a) hapi i parë – operacioni i shitjes; dhe

b) hapi i dytë – operacioni i riblerjes.

3. Hapi i dytë, gjenerohet automatikisht në sistemin AFISaR, në momentin që hapi i parë është plotësisht i shlyer. Ky hap do të procesohet për shlyerje në momentin e përcaktuar fillimisht në mesazhin përkatës, nëpërmjet të cilit urdhërohet shlyerja e operacioneve të marrëveshjeve të riblerjes.

4. Në rast se hapi i dytë dështon të shlyhet në fund të ditës së shlyerjes së përcaktuar, ai riciklohet automatikisht edhe për 1 (një) ditë pune. Në rast të mos shlyerjes edhe në ditën e



ricikluar, atëherë hapi i dytë anulohet dhe marrëveshja e riblerjes njehsohet me një marrëveshje shitblerjeje të shlyer në hapin e parë. Çdo penalitet në lidhje me riciklimin apo dështimin në shlyerjen e hapit të dytë, si dhe termat e zgjidhjes së dështimit, përcaktohen dhe zgjidhen nga pjesëmarrësit jashtë sistemit AFISaR.

5. Në sistemin AFISaR realizohen marrëveshjet e riblerjes që i kanë të dy hapat të përcaktuara nga pjesëmarrësit për shlyerje brenda ditës ose në ditë të ndryshme.

6. Nëpërmjet një marrëveshje riblerjeje mund të tregohet një titull në një kohë.

7. Operacionet e marrëveshjeve të riblerjes nuk do të pranohen në sistem nëse gjatë periudhës midis shlyerjes së hapit të parë dhe asaj të hapit të dytë, bie data e maturimit të titullit, i cili tregtohet në këtë operacion.

8. Në rastin kur data e shlyerjes së hapit të dytë bie ditë pushimi, shlyerja do të bëhet ditën pasuese të punës. Çdo pagesë kompensimi midis pjesëmarrësve, që mund të lindë si pasojë e kësaj, do të zgjidhet nga pjesëmarrësit jashtë sistemit AFISaR.

9. Në qoftë se në periudhën midis shlyerjes së hapit të parë dhe hapit të dytë të marrëveshjes së riblerjes, ka pagesë të interesit/kuponit nga emetuesi i titullit që është tregtuar me marrëveshjen e riblerjes, interesin/kuponi i paguhet mbajtësit të përkohshëm të titullit (blerësi). Në zbatim të kontratës tip për riblerjen e titujve, sistemin AFISaR do të iniciojë një transaksion për transferimin e fondeve për të kthyer vlerën e përfituar nga mbajtësi i përkohshëm i titullit (blerësi në hapin e parë), tek zotëruesi i tyre (shitësi në hapin e parë). Ky do të jetë një transaksion FOD, që nuk mund të anulohet, por në pamundësi shlyerje do të riciklohet në pafundësi.

10. Pjesëmarrësit mund të iniciojnë në çdo kohë, që prej shlyerjes së hapit të parë deri një ditë përpara shlyerjes së hapit të dytë, operacione për zëvendësimin e titullit të tregtuar, nëpërmjet marrëveshjes së riblerjes. Ky është transaksion i tipit dorëzim kundrejt dorëzimit (DVD). Zëvendësimi kërkon dërgimin nga secili pjesëmarrës në transaksion të dy mesazheve ku specifikohet kodi unik i transaksionit fillestar, ku njëri prej mesazheve lidhet me operacionin e

rikthimit të titullit të tregtuar në marrëveshjen fillestare dhe mesazhi tjetër lidhet me operacionin e dorëzimit të titullit. Sistemi AFISaR do t'i procesojë të dyja këto transaksione si transaksione dorëzim kundrejt dorëzimit, ku pagesa bëhet nëpërmjet titullit, duke kaluar në etapat e përshkruara në nenin 11. Në këtë mënyrë, për shlyerjen e këtyre dy operacioneve, si titulli që është për t'u rikthyer nga blerësi në hapin e parë ashtu edhe titulli që është për t'u dorëzuar nga shitësi në hapin e parë, duhet të rezervohen.

11. Pjesëmarrësit mund të bien dakord për përfundimin e marrëveshjes së riblerjes përpara ose pas kohës së përcaktuar në instruksionet fillestare. Përfundimi i hershëm i një marrëveshjeje riblerje bëhet nëpërmjet mesazheve të përcaktuara në shtojcën 6 në ditën kur dëshirohet përfundimi i marrëveshjes. Për të zgjatur marrëveshjen duhet dërguar një mesazh për përfundimin e marrëveshjes aktuale dhe pastaj mesazhi i zakonshëm për një marrëveshje të re.

12. Në rast se emetuesi iniciacion një maturim të përkohshëm sipas përcaktimit në nenin 30, pika 1 për një titull/tituj që janë tregtuar në marrëveshjeje riblerjeje midis pjesëmarrësve, dhe pjesëmarrësit nuk kanë ndërmarrë një operacion për zëvendësimin e këtij titulli sipas pikës 9 deri në ditën e përcaktuar nga emetuesi për maturimin e parakohshëm, atëherë maturimi do kalojë në llogarinë e mbajtësit të përkohshëm të titullit (blerësit në hapin e parë) dhe marrëveshja e riblerjes do të konsiderohet e përfunduar. Palët njoftohen për përfundimin e kontratës. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve bëhet jashtë sistemit.

13. Pjesëmarrësit e përfshirë në një marrëveshje riblerjeje, mund të iniciojnë operacione për transferimin e titujve për të plotësuar kërkesën për marzhin e ruajtjes së vlerës së titullit të tregtuar. Vlera e marzhit, dakordohet nga pjesëmarrësit jashtë sistemit AFISaR. Sistemi do të procesojë një operacion për transferimin e titujve në plotësim të marzhit të ruajtjes së vlerës së titullit, kur të dy pjesëmarrësit do të dërgojnë mesazhet sipas tipit të përcaktuar në shtojcën 6. Data e shlyerjes së këtyre mesazheve duhet të jetë pas shlyerjes së hapit të parë të marrëveshjes dhe përpara shlyerjes së hapit të dytë.



14. Për marrëveshjet e riblerjes me tituj në valutë, shlyerja në AFISaR ndodh sipas përshkrimit në nenin 33, pika 4, ku konfirmimi për shlyerjen e fondeve vjen nga dorëzuesi i titullit.

15. Huadhënia e titujve është një rast i marrëveshjes së riblerjes, por që në sistem dallohet nga emërtimi.

Neni 36

Kredia brenda ditës nga Banka e Shqipërisë

1. Kredia brenda ditës akordohet nga Banka e Shqipërisë sipas përcaktimeve në rregulloren “Për kredinë brenda ditës për bankat”.

2. Operacionet e kredisë brenda ditës janë në formën e marrëveshjeve të riblerjes, ku hapi i parë dhe hapi i dytë sipas përshkrimit në nenin 35, pika 2, shlyhen brenda ditës. Këto operacione realizohen nëpërmjet pjesëmarrësve që lejohen të përdorin këtë operacion dhe Bankës së Shqipërisë.

3. Shlyerja e hapit të parë nuk vihet asnjëherë në radhë pritjeje për tituj në llogarinë e pjesëmarrësit. Në rast se titujt mungojnë në llogari, atëherë operacioni refuzohet.

4. Pjesëmarrësit iniciojnë një operacion për kredi brenda ditës, duke dërguar një mesazh sipas Manualit të Përdorimit ku specifikohet shuma e kredisë brenda ditës që kërkohet dhe titujt që do të vendosen si garanci. Në këtë rast, hapi i përputhshmërisë sipas përcaktimeve në nenin 11 zëvendësohet me një vlerësim automatik të sistemit, i cili siguron që:

a) në hapin e parë të shlyerjes, fondet që kalojnë në llogarinë e cash-it të pjesëmarrësit nga Banka e Shqipërisë nëpërmjet sistemit AIPS, janë në vlerë më të vogël ose të barabartë me vlerën e pranueshme të titullit të llogaritur sipas përcaktimit në rregulloren e “Kredisë brenda ditës”;

b) në hapin e dytë të shlyerjes, fondet që kalojnë nga llogaria e pjesëmarrësit në sistemin AIPS në llogarinë e Bankës së Shqipërisë, janë në vlerë më të lartë ose të barabartë me vlerën e pranueshme të titullit të llogaritur sipas përcaktimit në rregulloren e “Kredisë brenda ditës”.

Sistemi e refuzon akordimin e kredisë brenda ditës, kur këto dy kushte nuk plotësohen. Pavarësisht këtyre kushteve, pjesëmarrësit e

lejuar duhet të kujdesen që shuma e fondeve në hapin e dytë duhet të jetë e barabartë me shumën e fondeve në hapin e parë.

5. Instruksionet e kredisë brenda ditës duhet të autorizohen nga Banka e Shqipërisë në mënyrë që kredia të lëvrohet.

6. Në rast se pjesëmarrësi nuk përcakton një orë për shlyerjen e hapit të dytë të operacionit të kredisë brenda ditës, atëherë sistemi nis shlyerjen në orën e përcaktuar në shtojcën 7.

7. Në rast se pjesëmarrësi nuk ka fonde në llogarinë e tij për të shlyer hapin e dytë të operacionit, atëherë pjesëmarrësi kërkon akordimin e kredisë njëditore në përputhje me rregulloren e Bankës së Shqipërisë “Për kredinë njëditore” dhe sipas procesit të marrëveshjeve të kolateralit financiar të përcaktuar në nenin 38. Pjesëmarrësi nuk mund të vendosë të njëjtin titull të vendosur si garanci për kredinë brenda ditës për kredinë njëditore automatike.

8. Në rast se operacioni për akordimin e kredisë nuk realizohet deri në orën e përfundimit (cut-off) të shërbimit DVP, sistemi do e anulojë hapin e dytë të shlyerjes së kredisë brenda ditës, dhe titulli do mbetet në llogarinë e titujve të Bankës së Shqipërisë.

Neni 37

Marrëveshjet e kolateralit financiar

1. Sistemi shlyen dhe regjistron marrëveshjet e kolateralit financiar me tituj, të lidhura ndërmjet personave juridikë të mëposhtëm:

a) pjesëmarrësve të drejtpërdrejtë për llogarinë e tyre vetjake;

b) pjesëmarrësit të drejtpërdrejtë për llogari të tij dhe klientit të tij që është pjesëmarrësi i tërthortë me llogari individuale, por që është person juridik;

c) pjesëmarrësit të drejtpërdrejtë për llogari të tij dhe një pjesëmarrësi të tërthortë, që është person juridik, me llogari individuale, në një pjesëmarrës tjetër të drejtpërdrejtë.

2. Njëra nga palët e marrëveshjes së kolateralit financiar, të lidhur sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të jetë: Republika e Shqipërisë, Banka e Shqipërisë, një bankë qendrore e huaj, një bankë, një institucion financiar, një institucion i huaj i ngjashëm me bankat dhe institucionet financiare, një agent shlyerës, një operator, ose një autoritet publik vendas ose ndërkombëtar.



3. Marrëveshja e kolateralit financiar mund të ketë subjekt më shumë se një titull.

Neni 38

Regjistrimi i marrëveshjeve të kolateralit financiar

1. Në një marrëveshje të kolateralit financiar, pjesëmarrësi që jep titullin si kolateral njihet në sistem si pengdhënësi, ndërsa pjesëmarrësi që pranon titullin si kolateral njihet në sistem si pengmarrësi.

2. Operacionet e kolateralit financiar me tituj, janë operacione që shlyhen sipas përcaktimit modelit DVP 1, përveç rastit të përshkruar në nenin 34, pika b, të cilat janë transferta FOP.

3. Regjistrimi i titujve si kolateral bëhet nëpërmjet mesazheve sipas shtojcës 6, të dërguar nga të dy palët në kontratë dhe kalon nëpër të gjithë hapat e përshkruara në nenin 11, përveç titujve në valutë, për të cilat regjistrimi ndodh sipas përshkrimit në nenin 33, pika 4.

4. Regjistrimi i titullit si kolateral ndodh në hapin e përshkruar në pikën 5 të nenit 11. Regjistrimi i kolateralit bëhet në llogarinë e pengdhënësit, në sektorin “kolateral”.

5. Në rast se marrëveshja e kolateralit financiar ka më shumë se një titull, atëherë ajo pranohet vetëm nëse të gjithë titujt janë të lirë në llogarinë e pengdhënësit.

Neni 39

Lirimi i kolateralit financiar

1. Në ditën e përcaktuar nga pjesëmarrësit palë në marrëveshjen e kolateralit financiar, për lirim të titullit të vendosur si kolateral, sistemi AFISaR inicion automatikisht procedurat për lirim të titullit të vendosur si kolateral.

2. Në rast të shlyerjes përfundimtare të transaksionit, titulli i vendosur si kolateral lirohet dhe kalon nga sektori “kolateral” në llogarinë e pengdhënësit, duke iu shtuar balancës së titujve, duke u bërë në këtë mënyrë i disponueshëm për pengdhënësin.

3. Në rast se, si rezultat i mungesës së fondeve të pengdhënësit, transaksioni nuk është shlyer deri në DVP cut-off, atëherë:

a) për marrëveshjet e kolateralit financiar, në të cilat njëra palë është Banka e Shqipërisë, titulli kalon në llogarinë vetjake të Bankës së Shqipërisë;

b) për marrëveshjet e kolateralit financiar, në të cilat palë janë pjesëmarrës të tjerë, të ndryshëm nga Banka e Shqipërisë, titulli kalon në sektorin “të ndaluara” të llogarisë së pengdhënësit.

Neni 40

Realizimi i kolateralit financiar

1. Realizimi i kolateralit financiar që ka për objekt titullin, mund të bëhet nëpërmjet shitjes ose përvetësimit, duke dërguar instruksione pagese sipas përcaktimeve të Manualit të Përdorimit të sistemit AfISaR.

2. Pengmarrësi ka të drejtë të realizojë titullin/titujt e marrë si kolateral sipas marrëveshjes së kolateralit financiar, vetëm kur ato ndodhen në sektorin “të ndaluara” të llogarisë së pengdhënësit.

3. Në qoftë se ka tituj të regjistruar si kolateral, pjesë e një marrëveshjeje të kolateralit financiar të pamaturuar, apo janë në sektorin “të ndaluara” të llogarisë së pengdhënësit, të cilët arrijnë datën e maturimit, sistemi automatikisht do i kalojë titujt në sektorin “të diskutueshëm” të llogarisë së titujve të pengdhënësit në ditën e regjistrimit. Në ditën e pagesës së maturimit, vlera e maturimit do të shkojë në një llogari speciale të Bankës së Shqipërisë, ndërsa vlera e interesit, në qoftë se ka të tillë, në llogarinë e cash-it të pengdhënësit.

4. Banka e Shqipërisë kalon vlerën e maturimit të titullit, nga llogaria speciale, sipas pikës 3, në llogarinë e pengmarrësit, sipas rastit, me kërkesë të pengdhënësit, me konfirmim nga të dyja palët (pengmarrësi dhe pengdhënësi), ose me urdhër/akt të organeve gjyqësore.

Neni 41

Përfundimi para afatit i marrëveshjes të kolateralit financiar

1. Pengmarrësi dhe pengdhënësi mund të bien dakord të përfundojnë para afatit marrëveshjen e kolateralit financiar. Për realizimin e përfundimit të marrëveshjes, të dyja palët duhet të dërgojnë mesazh sipas përcaktimit në Shtojcën 6, në ditën e dëshiruar për përfundimin e marrëveshjes.

2. Në qoftë se operacioni për lirim të kolateralit përpara ditës së maturimit të marrëveshjes së kolateralit financiar nuk realizohet për mungesë të fondeve të pengdhënësit deri në DVP cut-off, atëherë



transaksioni anulohet dhe titulli mbetet i regjistruar si kolateral në llogarinë e pengdhënësit.

3. Të gjithë titujt ose një/disa prej tyre mund të zëvendësohen nëpërmjet instruksioneve të të dy palëve në kontratë. Palët vendosin kodin unik të kontratës fillestare në instruksionet për zëvendësimin e titujve. Zëvendësimi i titujve në një marrëveshje të kolateralit financiar është i njëjtë me përshkrimin në nenin 35 pika 10.

Neni 42

Mekanizmi “Gridlock”

Sistemi nis automatikisht mekanizmin Gridlock, për zgjidhjen e situatës së krijuar nga instruksionet e mbajtura në radhë, duke shlyer në fillim transaksionet që janë në gjendje për t'u shlyer, duke e ndryshuar radhën e transaksioneve që kanë të njëjtin prioritet.

KREU VI

MJETET E KOMUNIKIMIT NË SISTEMIN AFISAR

Neni 43

Komunikimi

1. Pjesëmarrësit e sistemit, nëpërmjet nënshkrimit të kontratës për pjesëmarrje, bien dakord me administratorin për të komunikuar me sistemin me një nga mënyrat e përshkruara në këtë rregullore.

2. Komunikimi i emetuesit në sistemin AFISaR i nënshtrohet rregullave të përcaktuara në këtë rregullore. Aspekte të tjera të komunikimit midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave, në lidhje me operacionet që kryhen në sistemin AFISaR, rregullohen nëpërmjet marrëveshjes së lidhur midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave.

3. Me kërkesë të pjesëmarrësit(ve), ose kur nga rrethanat e krijuara administratori e gjykon të arsyeshme, ai mund të lejojë në mënyrë të përkohshme komunikimin me mjete të tjera, për të cilat sigurohet që kanë sigurinë e mjaftueshme për të mos rrezikuar sigurinë e sistemit.

4. Komunikimi elektronik është subjekt i dispozitave të sigurisë të përcaktuara në udhëzimin e Bankës së Shqipërisë “Mbi përdorimin e internetit dhe postës elektronike në Bankën e Shqipërisë”.

Neni 44

Komunikimi nëpërmjet VPN

1. Aksesit për komunikimin nëpërmjet VPN do t'i jepet vetëm pjesëmarrësve të drejtpërdrejtë që kanë të drejtë për këtë mënyrë komunikimi, sipas përcaktimeve në rregulloren “Për sigurinë e informacionit” të Bankës së Shqipërisë.

2. Pjesëmarrësit që komunikojnë nëpërmjet VPN, do kenë mundësi të aksesojnë sistemin nëpërmjet webstation-it. Ky akses u jep mundësi:

a) të iniciojnë udhëzimet për të debituar/kredituar llogarinë e tyre ose të klientëve të tyre. Udhëzimet kryhen nga workstation-i, duke dërguar mesazhe të përcaktuara sipas tipit të transaksionit në shtojcën 6;

b) të monitorojnë statusin e transaksionit të tyre, duke lexuar statutet e përshkruara në shtojcën 6;

c) të monitorojnë llogarinë e tyre dhe të klientëve të tyre;

d) të monitorojnë ngjarjet që lidhen me titujt, siç janë pagesat e kuponave dhe maturimet;

e) të realizojnë pjesëmarrjen në ankand primar për llogari të tyre dhe të klientëve të tyre;

f) të marrin të gjithë informacionin që lidhet me rezultatin e pjesëmarrjes në ankandin primar;

g) të monitorojnë përdorimin e sistemit nga përdoruesit e tyre.

Neni 45

Komunikimi nëpërmjet SWIFT-it

1. Komunikimi nëpërmjet SWIFT-it do të jetë i detyrueshëm për të gjithë pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë, të cilëve nuk mund t'iu jepet akses nëpërmjet VPN.

2. Komunikimi nëpërmjet SWIFT-it do të kryhet në përputhje me Manualin e SWIFT-it.

3. Pjesëmarrësit që do komunikojnë nëpërmjet SWIFT-it, do kenë mundësi të kryejnë veprimet e mëposhtme:

a) të iniciojnë udhëzimet për të debituar/kredituar llogarinë e tyre ose të klientëve të tyre. Udhëzimet kryhen nëpërmjet mesazheve të përcaktuara sipas tipit të transaksionit në shtojcën 6;

b) të njoftohen mbi statusin e transaksionit të tyre nëpërmjet mesazheve të dërguara nga sistemit AFISaR në përputhje me shtojcën 6.



Neni 46

Komunikimi me urdhra me shkrim

1. Urdhrat me shkrim janë, si rregull, të pranueshëm vetëm për pjesëmarrësit e tërthorë. Nëpërmjet këtyre urdhrave, këta pjesëmarrës urdhërojnë administratorin e sistemit që të operojë në emër të tyre.

2. Urdhri me shkrim pranohet, si rregull, në formën origjinale të shkresave zyrtare të nënshkruara dhe vulosura nga personat e autorizuar përfaqësues të personave juridikë ose të nënshkruara nga personat fizikë. Për efekt të menaxhimit të kohës, por jo në zëvendësim të formës origjinale, administratori mund të pranojë transmetimin e këtyre urdhrave nëpërmjet faksit ose të skanuara nëpërmjet postës elektronike.

3. Këta pjesëmarrës mund të përdorin formën e urdhrat të përcaktuar në shtojcën 9 ose një dokument tjetër, i cili i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në formën e përcaktuar të urdhrat. Ky urdhër mbahet në dy kopje. Një kopje do t'i dërgohet administratorit të sistemit dhe tjetra do mbahet nga pjesëmarrësi.

4. Administratori i sistemit rezervon të drejtën e refuzimit të ekzekutimit të urdhrat, nëse konstaton se urdhri është i palexueshëm, subjekt i interpretimeve, ose ka gabime thelbësore.

KREU VII**EVIDENTIMI I VEPRIMEVE NË LLOGARI, RAPORTIMI DHE RAKORDIMI**

Neni 47

Evidentimi i veprimeve në llogarinë e titullit në sistemin AFISaR

1. Në llogarinë e titujve të pjesëmarrësve ose klientëve të tyre, në sistemin AFISaR evidentohen veprimet e mëposhtme:

- a) veprimet për blerjen e titujve në tregun primar;
- b) transaksionet me titujt në tregun sekondar;
- c) transfertat FOP të titujve;
- d) maturimi i titullit;
- e) transaksionet e marrëveshjes së riblerjes dhe huadhënies së titujve; dhe
- f) regjistrimi i titullit si kolateral.

Neni 48

Raportimi

1. Administratori nëpërmjet sistemi AFISaR njofton pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë mbi:

a) balancën e llogarisë/ve në sistemin e regjistrimit të instrumenteve financiare të hapura në emër të tyre në AFISaR;

b) transaksionet e kryera përmes llogarive në sistemin e regjistrimit të instrumenteve financiare, të hapura në emër të tyre në AFISaR;

c) transaksionet e tyre të mbajtura në radhë pritje (pezull).

2. Sistemi vë në dispozicion të pjesëmarrësve të drejtpërdrejtë, të cilët kanë akses në webstation, raporte të ndryshme të cilat mund të gjenerojnë gjatë ditës ose në fund të ditës. Raporte të tilla, ndryshe nga ato zyrtare, nuk përmbajnë nënshkrim. Administratori nuk mund të mbajë përgjegjësi për saktësinë e raporteve të panënshkruara. Nëse pjesëmarrësit dëshirojnë që raportet t'u dërgohen zyrtarisht, ata mund të kërkojnë që raportet e dërguara nga sistemi të kenë nënshkrimin dixhital.

3. Pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë, të cilët e aksesojnë sistemin nëpërmjet SWIFT-it, mund të kërkojnë raportim sipas frekuencës së dëshiruar të shprehur në kontratën e lidhur midis tyre dhe administratorit, kundrejt pagesave sipas përcaktimeve në Shtojcën 8.

Neni 49

Regjistrimi dhe rakordimi

1. Titujt e regjistruar në sistemin AFISaR, përmbajnë ndër të tjera edhe elementet e mëposhtme:

- a) llojin e titullit;
- b) serinë identifikuese të titullit;
- c) datën e emetimit;
- d) datën e maturimit;
- e) emetuesin;
- f) vlerën nominale total;
- g) vlerën nominale më të vogël të lejuar për tregtim;
- h) monedhën;
- i) normën e interesit në momentin e emetimit; dhe
- j) afatin dhe mënyrën e pagesës së interesit.



2. Administratori dërgon brenda 3 (tri) ditësh pune të muajit pasardhës, gjendjen e llogarisë së titullit të pjesëmarrësit dhe klientëve të tij, të detajuar sipas llojit të titullit për ditën e fundit të muajit paraardhës. Në rast se nuk ka reklamime deri në 5 (pesë) ditë më pas ditës së dërgimit, informacioni i dërguar quhet i pranuar.

3. Për çdo reklamim, administratori dhe pjesëmarrësi do investigojnë për arsyet e mos rakordimit, si dhe pas sqarimit të arsyeve, do vendosin dhe pranojnë informacionin e saktë dhe detyrat e secilit për saktësimin e tij.

KREU VIII

FATURIMI DHE ORARET E PUNËS

Neni 50

Përcaktimi i komisioneve

1. Administratori mund të përcaktojë komisione për pjesëmarrjen në sistemin AFISaR, për të mbuluar shpenzimet që lidhen me operimin e sistemit dhe koston e tij.

2. Komisionet mund të jenë për pjesëmarrjen në AFISaR dhe për operacionet e veçanta që realizohen në këtë sistem.

3. Përjashtohen nga komisionet Ministria e Financave dhe personat fizikë që hapin llogari nëpërmjet Bankës së Shqipërisë. Përjashtime të tjera bëhen me vendim të Këshillit Mbikëqyrës.

4. Komisionet për pjesëmarrësit përfshijnë:

- komisione për anëtarësimin në sistem;
- komisione për pjesëmarrjen;
- komisione për daljen nga sistemi;

Komisionet për pjesëmarrësit do të paguhen një herë në vit.

5. Komisionet për operacionet e veçanta përfshijnë:

a) operacionet DVP, ku përfshihen shitblerjet, marrëveshjet repo, marrëveshjet e kolateralit financiar;

b) operacionet FoP, ku përfshihen operacionet e përshkruara në nenin 34;

c) procesimin e transaksioneve në tregun primar;

d) menaxhimin e kolateralit financiar sipas hapave të përshkruara në nenet 38 deri 41

e) kredinë brenda ditës;

f) riciklimin e shlyerjes së veprimeve në tregun primar, si rezultat i mungesës së fondeve.

6. Komisione aplikohen për të dy palët në transaksion, përveç operacionit sipas shkronjës “e” dhe “f”, dhe operacioneve midis pjesëmarrësit dhe klientit të tij, ku komisioni paguhet vetëm nga pjesëmarrësi i drejtpërdrejtë.

Neni 51

Nxitja nëpërmjet komisioneve

Administratori në shërbim të mirë-funksionimit të sistemit dhe nxitjes për përdorimin e tij mund të aplikojë zbritje në komisionet e aplikuara në rastet e:

a) vëllimit të lartë të transaksioneve të procesuara në sistem;

b) inicimit të veprimeve në orët e para të hapjes së sistemit.

Neni 52

Njoftimet mbi komisionet

1. Komisionet dhe zbritjet jepen të detajuara në shtojcën 8.

2. Komisionet dhe zbatimi i tyre mund të ndryshohen nga administratori i sistemit.

3. Administratori njofton pjesëmarrësit të paktën 30 (tridhjetë) ditë përpara hyrjes në fuqi të komisioneve.

Neni 53

Faturimi

1. Komisionet iu faturohen pjesëmarrësve të ndara sipas zërave në bazë ditore, për ditën paraardhëse të punës.

2. Pjesëmarrësit kanë të drejtë të paraqesin ankim në rast se venë re pasaktësi në faturën e tyre.

3. Administratori duhet t'i kthejë përgjigje ankesës brenda 5 (pesë) ditësh pune nga data e marrjes së ankesës.

Neni 54

Ditët e punës të sistemit

1. Sistemi AFISaR është i hapur dhe aktiv në ditët e punës në Republikën e Shqipërisë.

2. Administratori kujdeset që ditët e punës së sistemit AFISaR dhe sistemit AIPS të jenë të njëjta.

3. Administratori njofton pjesëmarrësit për kalendarin e festave zyrtare, përpara fillimit të vitit kalendarik.



4. Pjesëmarrësit kanë përgjegjësi të vetë-kujdesen për kalendarin e festave zyrtare në vendet e origjinës së monedhës së huaj, kur janë pjesëmarrës në transaksione në monedhë të huaj.

Neni 55

Orës e punës të sistemit

1. Orari i punës së sistemit AFISaR janë të përcaktuara në shtojcën 8, por administratori ka të drejtë t'i modifikojë edhe gjatë ditës së punës, për të ruajtur mbarëvajtjen e sistemit.

2. Administratori njofton menjëherë pjesëmarrësit për ndryshimin e orareve të punës.

KREU IX

INSTRUKSIONET E PAGESAVE

Neni 56

Pandryshueshmëria e instruksioneve

1. Momenti që një instruksion futet në Sistemin AFISaR është momenti i pranimit teknik të pagesës nga sistemi. Në përputhje me përcaktimet në këtë rregullore, momenti i pranimit teknik është koha kur sistemi, bazuar në instruksionet e pjesëmarrësit, menjëherë pas validimit të mesazhit dhe përputhjes së mesazheve sipas nenit 11, pika 3, krijon një transaksion të cilit i cakton një kod unik.

2. Duke filluar nga momenti i futjes në sistem, instruksionet nuk mund të tërhiqen nga një pjesëmarrës ose palë e tretë. Kjo vlen edhe në rast të hapjes së procedurës së paaftësisë paguese kundër një pjesëmarrësi, sipas përcaktimit në kreun X.

3. Pas këtij momenti, instruksioni i pagesës në sistemin AFISaR mund të anulohet nga administratori i sistemit, sipas përcaktimit në nenin 58. Administratori i sistemit mund të revokojë instruksionet e pagesave të hedhura në sistem nga pjesëmarrësit, në periudhën ndërmjet momentit të pranimit teknik dhe momentit të pranimit për shlyerje.

4. Një instruksion pagese i urdhëruar nga pjesëmarrësi i drejtpërdrejtë për të debituar/kredituar llogarinë e një klienti, kur ky klient në sistemin AFISaR është i paidentifikuar, por është pjesë e një llogarie omnibus të pjesëmarrësit, gjeneron detyrim të pjesëmarrësit ndaj kundërpalës që ka lëshuar instruksionin në rast se pjesëmarrësi ka iniciuar instruksionin

përkatës dhe ka pasur përputhje të mesazheve të pjesëmarrësit dhe kundërpalës së tij, si dhe është bërë pranimi teknik i instruksioneve. Çdo konflikt për pasaktësinë e instruksioneve apo mungesën e shlyerjes së tyre, në këtë rast, zgjidhet nga palët jashtë sistemit AFISaR.

5. Një instruksion pagese i urdhëruar nga pjesëmarrësi i drejtpërdrejtë për të debituar llogarinë e një klienti, kur ky klient ka llogari individuale, nëpërmjet këtij pjesëmarrësi të drejtpërdrejtë në sistemin AFISaR, nuk gjeneron detyrim të pjesëmarrësit kundrejt kundërpalës që ka lëshuar instruksionin, edhe në rastin kur ka ndodhur pranimi teknik i instruksioneve të pagesës nga të dy palët, përveç rastit kur në llogarinë e klientit ka titujt të mjaftueshëm për të debituar llogarinë.

Neni 57

Anulimi i instruksioneve nga pjesëmarrësit

1. Pjesëmarrësit mund të kërkojnë që instruksionet e pagesave të hedhura në sistem të anulohen.

Anulimi i instruksioneve mund të bëhet nga pjesëmarrësit, kur ende nuk ka ndodhur përputhja e mesazheve.

2. Në rast se sistemi mund të procesojë kërkesën e kthimit nga pjesëmarrësi, sistemi do të anulojë instruksionet në fjalë dhe do t'i dërgojë pjesëmarrësit një njoftim konfirmimi për ekzekutimin e kërkesës. Në rast se kërkesa respektive nuk mund të procesohet sepse pjesëmarrësi nuk ka më të drejtë të anulojë instruksionin dhe/ose sepse instruksioni është shlyer tashmë, sistemi njofton pjesëmarrësin.

3. Për të kërkuar anulimin e një instruksioni, pjesëmarrësit do të dërgojnë një mesazh sipas tipit të përcaktuar në shtojcën 6. Lloji i mesazhit të dërguar varet nga lloji i mesazhit të dërguar fillimisht, të cilin pjesëmarrësi dëshiron ta anulojë.

4. Instruksionet që nuk janë përputhur, mund të anulohen deri në orarin e cut-off të shërbimit përkatës në ditën e shlyerjes. Nëse këto instruksione nuk anulohen nga pjesëmarrësi, ato do të fshihen automatikisht nga sistemi në fund të ditës së shlyerjes.



Neni 58

Anulimi i instruksioneve nga administratori

1. Administratori mund të anulojë instruksionet e pagesave në sistemin AFISaR, vetëm në qoftë se veprimi me fondet nuk është shlyer ende në sistemin AIPS ose nuk është dërguar ende konfirmimi i kredititmit nga dorëzuesi i titullit në rastet e transaksioneve në tregun sekondar të titujve në valutë. Sistemi AFISaR njofton për anulim sistemin AIPS për titujt në ALL dhe në qoftë se gjatë kohës që sistemi AFISaR pret nga AIPS konfirmimin e anulimit, vjen një konfirmim për shlyerjen e fondeve nga sistemi AIPS, atëherë transaksioni në AFISaR shlyhet në mënyrë përfundimtare.

2. Administratori mund të anulojë instruksionet e pagesave:

a) në një rast të paparashikuar, por duke e mbështetur dhe argumentuar ligjërisht;

b) bazuar në vendimin e një autoriteti kompetent, duke e mbështetur dhe argumentuar ligjërisht.

Neni 59

Anulimet automatike të instruksioneve

Anulimet automatike të instruksioneve të pagesave në sistemin AFISaR ndodhin:

a) në rast se instruksionet nuk janë përputhur ose shlyer përpara cut-off të përfundimtar;

b) në rast se një anulim i instruksioneve të cash-it ndodh në sistemin AIPS, në bazë të rregullave të këtij sistemi.

KREU X PROCEDURAT PËR PAAFTËSI PAGUESE

Neni 60

Kushte të përgjithshme

1. Administratori pezullon menjëherë pjesëmarrësit për të cilin njoftohet zyrtarisht se i është hapur procedura për paaftësi paguese.

2. Instruksionet e pagesës të iniciuara nga pjesëmarrësi me paaftësi paguese dhe të futura në sistem përpara dërgimit të njoftimit për hapjen e procedimit për paaftësi paguese do të procesohen për shlyerje finale (të pakthyeshme), sipas nenit 11 të kësaj rregulloreje.

Neni 61

Hapja e procedimit për paaftësi paguese gjatë ditës së punës

Në rast se administratori i sistemit njoftohet për vendimin për hapjen e procedimit për paaftësi paguese në një moment gjatë ditës së punës, ai do të marrë masat si më poshtë:

a) menjëherë do të kufizojë llogarinë/të e pjesëmarrësit përkatës, në përputhje me rregulloret në fuqi, në mënyrë që pjesëmarrësi të mos ketë më mundësi të iniciojë instruksione, duke përdorur llogarinë/të përkatëse, përveçse për:

i) instruksione për transferimin e të titujve për llogari të klientëve të tij,

ii) instruksione për shlyerjen neto, të lidhura me shlyerjen e rezultateve të tregut primar dhe/ose pagesat e kuponave/interetit,

iii) instruksione pagese për përvetësimin e kolateralit nga pengmarrësi;

b) Të njoftojë menjëherë pjesëmarrësit e tjerë rreth kufizimit të vendosur mbi atë pjesëmarrës;

c) Të kthejë të gjitha instruksionet në sistem pasi pjesëmarrësi është bërë subjekt kufizimi, përveç instruksioneve sipas pikës “a”;

d) Instruksionet e futura në sistem përpara hapjes së procedurës për paaftësi paguese, të cilat nuk janë shlyer dhe janë akoma në radhë, do të shlyhen deri në masën e disponueshmërisë së fondeve dhe/ose titujve. Në orarin e cut-off final të ditës së punës, sistemi do të anulojë automatikisht të gjitha instruksionet e hedhura në sistem nga ai pjesëmarrës, përveç atyre të cilat riciklohen sipas përcaktimeve në këtë rregullore dhe me shlyerje në ditët pasuese, që janë pranuar teknikisht nga sistemi.

Neni 62

Hapja e procedimit për paaftësi paguese pas përfundimit të ditës së punës

1. Në rast se administratori i sistemit njoftohet për hapjen e procedimit për paaftësi paguese pas fundit të ditës së punës, ai do të marrë të gjitha masat e nevojshme që pjesëmarrësi përkatës të mos ketë më mundësi të iniciojë ose të marrë instruksione për veprimet me tituj në ditën pasardhëse të punës, duke kufizuar të drejtat e pjesëmarrësit në sistem.



2. Administratori do të njoftojë pjesëmarrësit e tjerë rreth hapjes së procedimit për paaftësi paguese kundrejt një pjesëmarrësi, duke i dërguar atyre një e-mail të sigurt dhe /ose mesazh informues SWIFT-i, përpara fillimit të ditës pasardhëse të punës.

3. Veprimet që janë pranuar teknikisht nga sistemi dhe që kanë data shlyerje më vonë do të procesohen në përputhje me këtë rregullore.

4. Transferimet e llogarive të klientëve në një pjesëmarrës tjetër do të kryhen nga administratori, në përputhje me udhëzimet e autoritetit përkatës.

KREU XI KONFIDENCIALITETI

Neni 63

Konfidencialiteti

1. Pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë zbatojnë rregullat dhe normat e konfidencialitetit të informacionit mbi të gjitha instruksionet e pagesave të pranuar nga sistemi AFISaR. Secili nga pjesëmarrësit instrukton personelin përkatës, i cili ka të drejta për përdorimin informacionit mbi instruksionet e pagesave të pranuar në sistemin AFISaR, për ruajtjen e konfidencialitetit mbi këtë informacion, në përputhje me rregullat dhe normat e konfidencialitetit dhe me dispozitat e kësaj rregulloreje.

2. Procedurat për të garantuar sigurinë, pajisjet e sigurisë, kodet, fjalëkalimet dhe metoda të tjera të kontrollit të aksesit janë konfidenciale dhe pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë janë të detyruar t'i përdorin dhe t'i mbrojnë ato me përgjegjësinë maksimale. Në qoftë se pjesëmarrësit zbulojnë ose kanë arsye për të dyshuar se ndonjë nga këto procedura mund të rrezikohet, duhet të njoftojë menjëherë administratorin e sistemit.

3. Pjesëmarrësit autorizojnë njohjen nga stafi i përcaktuar i administratorit apo i ndonjë pale të tretë që ka marrëdhënie me administratorin, kudo që ndodhet kjo, të informacionit të nevojshëm për të siguruar ofrimin e shërbimeve të sistemit AFISaR tek pjesëmarrësit, duke ruajtur konfidencialitetin dhe sekretin bankar.

4. Të gjithë pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë, të cilët kanë të drejtë të hapin llogari për klientët e tyre në sistemin AFISaR, duhet të marrin me shkrim dakordësinë e klientit për përdorimin në

sistemit të të dhënave të tyre personale.

5. Administratori nuk është përgjegjës në rast se transmetimi/përmbajtja/përdorimi i të dhënave nga pjesëmarrësi (për vete ose për klientët e tij) dhe/ose SWIFT, si një ofrues i shërbimeve të mesazheve elektronike, nuk është bërë sipas rregullave të legjislacioneve përkatëse për mbrojtjen e të dhënave personale, në vendet e origjinës.

6. Dispozitat e këtij neni zbatohen nga pjesëmarrësi i drejtpërdrejtë dhe Administratori, edhe pas mbylljes së llogarisë së shlyerjes së pjesëmarrësit.

KREU XII ASPEKTET TEKNIKE TË MENAXHIMIT TË SISTEMIT AFISAR

Neni 64

Asistenca për përdoruesit e sistemit AFISaR

1. Administratori ngre dhe mban një qendër për asistencën e përdoruesve të sistemit AFISaR, ku pjesëmarrësit mund të adresohen për problemet e lidhura me të gjatë gjithë ditës së punës të sistemit AFISaR. Administratori njofton pjesëmarrësit për personat e kontaktit të kësaj qendre.

2. Për çdo kërkesë për pajisje sigurie, pjesëmarrësi paraqet pranë administratorit formularin e paraqitur në Shtojcën 13.

3. Në rast pamundësie të krijimit apo fshirjes së një përdoruesi në sistemin AFISaR, pjesëmarrësi i sistemit paraqet një kërkesë me shkresë zyrtare pranë administratorit, i cili kryen veprimin e kërkuar për këtë përdorues në sistemin AFISaR.

4. Në rast pamundësie të modifikimit të fjalëkalimit të një përdoruesi, pjesëmarrësi i sistemit AFISaR paraqet një kërkesë me shkresë zyrtare pranë administratorit, e cila i kryen këto veprime.

5. Në rast të fshirjes së një përdoruesi, pjesëmarrësi duhet të dërgojë pranë administratorit pajisjen e sigurisë, e cila mban certifikatën e tij të sigurisë për revokimin e saj.

6. Administratori rinovon çdo vit certifikatat dixhitale të përdoruesve të sistemit AFISaR, të paraqitura prej tyre në përfundim të afatit të skadencës.



Neni 65

Administrimi i ndryshimeve dhe kontrolli ndaj tyre

1. Ndryshimet në sistemin AFISaR janë si më poshtë:

- a) ndryshime funksionale dhe teknike të sistemit AFISaR;
- b) ndryshime në SWIFNet FIN dhe në standardet SWIFT;
- c) ndryshime në VPN.

2. Administratori njofton dhe udhëzon pjesëmarrësit para zbatimit të ndryshimeve të planifikuara të sistemit AFISaR, kur këto ndryshime ndikojnë tek pjesëmarrësi.

3. Ndryshimet apo korrektimet e nevojshme në procedurat, si dhe në dokumentacionin plotësues të sistemit AFISaR në raste ndryshimi, u njoftohen pjesëmarrësve.

4. Në rast ndryshimesh në operimin e sistemit AFISaR, lajmërohen paraprakisht të gjithë pjesëmarrësit, duke u dhënë kohën e nevojshme për t'u përgatitur, si dhe për krijimin e kushteve të nevojshme për testimin e lidhjes së sistemeve të tyre me sistemin AFISaR.

5. Administratori kryesisht, ose me kërkesë të argumentuar të pjesëmarrësit, mund të bëjë ndryshime në sistemin AFISaR, me qëllim sigurimin e funksionimit normal të tij. Në rastet kur ndryshimet e propozuara kanë ndikime tek pjesëmarrësit e sistemit AFISaR, administratori këshillohet paraprakisht me këta të fundit.

6. Administratori pas shqyrtimit të kërkesës së argumentuar të pjesëmarrësit për ndryshime në sistemin AFISaR, e njofton atë për pranimin ose refuzimin e saj, duke e shoqëruar këtë njoftim me argumentimet përkatëse.

7. Në rast se ndryshimet e lartpërmendura inicohen nga:

- a) administratori, kostot e ndryshimeve përballohen nga ai vetë;
- b) një pjesëmarrës i drejtpërdrejtë i cili i përket një grupi të caktuar profili, sipas dispozitave të kësaj rregulloreje, kostot e ndryshimeve do të konsultohen me të gjithë pjesëmarrësit e të njëjtit profil dhe do të vlerësohet mundësia e mbulimit nga të gjithë pjesëmarrësit e sistemit AFISaR, në mënyrë të barabartë;

c) emetuesi, kostot e ndryshimeve përballohen nga ai vetë ose nga administratori në bazë të vendimit të këtij të fundit.

8. Administratori nuk është i detyruar të këshillohet me pjesëmarrësin, në rastet kur nevoja për ndërhyrje në sistemin AFISaR është urgjente dhe çdo vonesë mund të shkaktojë vështirësi për pjesëmarrësit e sistemit AFISaR.

Neni 66

Modifikimet në komunikimin VPN të pjesëmarrësve

Pjesëmarrësit plotësojnë formularin e ndryshimeve në rrjetin VPN sipas shtojcës 14 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje, në çdo rast të ndryshimit të adresave të rrjetit internet ose të përdoruesve VPN.

Neni 67

Personat e kontaktit

1. Çdo pjesëmarrës dorëzon informacionin mbi personat e kontaktit pranë administratorit, sipas shtojcës 10. Administratori mban dhe përditëson listën e të gjithë personave të kontaktit të pjesëmarrësve.

2. Pjesëmarrësit në sistemin AFISaR njoftojnë menjëherë administratorin për çdo ndryshim në listën e personave të kontaktit

KREU XIII

NGJARJET E PAPANASHIKUARA DHE PROCEDURAT E EMERGJENCËS

Neni 68

Ngjarjet e paparashikuara

Ngjarjet e paparashikuara klasifikohen si më poshtë:

- a) ndërprerja e komunikimit pranë pjesëmarrësit;
- b) ngjarje të paparashikuara në komunikimin nëpërmjet SWIFT;
- c) ngjarje të paparashikuara të sistemit AFISaR;
- d) ngjarje të paparashikuara në rrjetin VPN.

Neni 69

Ndërprerja e komunikimit pranë pjesëmarrësit

1. Nëse një pjesëmarrës ndeshet me vështirësi teknike të cilat pengojnë:



a) inicimin e transaksioneve nëpërmjet workstation-it në sistemin AFISaR; ose

b) monitorimin e transaksioneve nëpërmjet workstation-it në sistemin AFISaR;

2. Pjesëmarrësit njoftojnë menjëherë administratorin për çdo ndryshim në rrethanat apo në kushtet e operimit me vështirësi.

3. Administratori, me marrjen e njoftimit nga pjesëmarrësi, identifikon problemin dhe udhëzon pjesëmarrësin për mundësi alternative.

Neni 70

Ngjarje të paparashikuara në komunikimin SWIFT

1. Në raste të ndërprerjes së zgjatur të lidhjes me SWIFT, administratori njofton pjesëmarrësit, konsultohet me suportin e kompanisë SWIFT, si dhe mban kontakte të vazhdueshme me këta pjesëmarrës.

2. Në raste kur është e pamundur të rivendoset lidhja me SWIFT, administratori udhëzon pjesëmarrësit për mënyrat alternative të komunikimit, si dhe luan rolin e operatorit për këta pjesëmarrës pasi ka marrë autorizimin nga ta.

Neni 71

Ngjarjet e paparashikuara të sistemit AFISaR

Në rastet e një defekti të zgjatur në sistemin AFISaR, administratori njofton pjesëmarrësit nëpërmjet kontakteve të emergjencës me e-mail, telefon ose mesazh SWIFT.

Administratori, kur e gjykon të arsyeshme, bën zhvendosjen në ambientin AFISaR backup dhe njofton pjesëmarrësit e sistemit AFISaR për kalimin në sistemin backup.

Neni 72

Ngjarje të paparashikuara në rrjetin VPN

Në rast defekti në linjën primare të internetit, vihet në funksionim linja backup e internetit.

Neni 73

Regjistrim i ngjarjeve të paparashikuara

Çdo pjesëmarrës regjistron të gjitha ngjarjet e paparashikuara dhe problemet e vërejtura në sistem dhe i raporton ato pranë administratorit brenda 2 (dy) ditësh pune nga fundi i çdo muaji kalendarik, sipas formatit të përcaktuar në

shtojcën bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Neni 74

Testimi i procedurave të Fallback Recovery në sistemin AFISaR

1. Administratori kryen çdo 6 (gjashtë) muaj testimin e procedurave të saj të Fallback Recovery për ngjarjet e paparashikuara, në bashkëpunim dhe me pjesëmarrësit e tjerë të sistemit AFISaR.

2. Administratori njofton pjesëmarrësit për kalimin e operacioneve të sistemit AFISaR live në sistemin AFISaR backup, për zhvillimin e testimit të procedurave të Fallback Recovery, si dhe për çdo veprim që ata duhet të ndërmarrin, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune para datës së testimit.

3. Për të aksesuar sistemin AFISaR backup, pjesëmarrësit adresohen në site-in backup të sistemit AFISaR nëpërmjet workstation-it të tyre.

Neni 75

Pezullimi i sistemit

1. Administratori mund të pezullojë pjesërisht apo tërësisht funksionimin e sistemit AFISaR, në rrethanat kur vazhdimi i funksionimit të tij do të kishte ndikim negativ mbi stabilitetin e sistemit, duke njoftuar menjëherë për këtë pjesëmarrësit.

2. Gjatë periudhës së pezullimit të funksionimit të sistemit, operacionet zhvillohen sipas mënyrës së përcaktuar rast pas rasti nga administratori.

3. Administratori rivendos funksionimin e sistemit AFISaR sa më shpejt që të jetë e mundur, duke njoftuar menjëherë të gjithë pjesëmarrësit.

Neni 76

Të fundit

1. Pjesëmarrësit në sistemin e regjistrimit të titujve të operuar nga Banka e Shqipërisë në përputhje me rregulloren “Për transaksionet me titujt ndërmjet bankave dhe funksionimin e sistemit të regjistrimit të titujve”, transferohen në sistemin AFISaR, por fillojnë aksesimin e sistemit ose operimin me llogaritë e tyre vetëm pasi kanë nënshkruar kontratën për pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë sipas shtojcave 1, 2 dhe 3. Plotësimi i dokumentacionit sipas kërkesave të



kësaj rregulloreje mund të bëhet edhe pas fillimit të punës së sistemin AFISaR live.

2. Personat fizikë që janë klientë të Bankës së Shqipërisë, për një periudhë 2 (dy)-vjeçare, mund të mbajnë llogari shlyerje për veprimet në cash. Kjo llogari mund të përdoret vetëm për maturimin e titujve që zotërojnë në momentin e transferimit të të dhënave nga sistemi i regjistrimit të titujve Book Entry në sistemin AFISaR

Neni 77

Hyrja në fuqi

Rregullorja hyn në fuqi menjëherë pas publikimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

ZËVENDËSKRYETAR
I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Elisabeta Gjoni

SHTOJCA 1

KONTRATA TIP PËR PJESËMARRJEN E DREJTPËRDREJTË

Kontrata e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë në Sistemin AFISaR (Albanian Financial Instruments Settlement and Registrations)

Palët:

Banka e Shqipërisë, në cilësinë e Administratorit të Sistemit AFISaR (më poshtë referuar si “Administratori”), me adresë: Sheshi “Skënderbej”, nr. 1, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar në këtë kontratë nga zoti Marian Gjermani, Drejtor i Departamentit të Operacioneve Monetare,
dhe

_____, në cilësinë e Pjesëmarrësit të drejtpërdrejtë (më poshtë referuar si “Pjesëmarrësi”), me adresë zyre në _____, me Licencë _____), përfaqësuar në këtë kontratë nga zonja/zoti me numër pasaporte/kartë identiteti _____.

Duke qenë se:

1. Në bazë të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe marrëveshjes ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave, Banka e Shqipërisë është agjent fiskal i Qeverisë;

2. në bazë të nenit 31 të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas së Republikës së Shqipërisë”, Banka e Shqipërisë, në cilësinë e agjentit fiskal të Qeverisë, krijon, mban sistemin e regjistrimit në llogari për titujt e shtetit, si edhe mbështet krijimin e tregut sekondar të titujve të shtetit, duke lehtësuar përdorimin e sistemit të regjistrimit; dhe

3. në bazë të nenit 12 të vendimit nr. _____, datë _____2014 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë “Për miratimin e rregullores “Për funksionimin e sistemit qendror të regjistrimit dhe të shlyerjes së titujve (AFISaR)” (më poshtë referuar si “Rregullorja”), subjekti që dëshiron të marrë pjesë në sistemin AFISaR, duhet të lidhë me Administratorin kontratën e pjesëmarrjes në sistemin AFISaR; bien dakord të lidhin këtë kontratë sipas kushteve të mëposhtme.

Neni 1

Objekti

Objekti i kontratës është përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve të Administratorit, të cilat lindin në kuadrin e ofrimit prej tij të shërbimeve të shlyerjes dhe regjistrimit të titujve në sistemin AFISaR, si pronar dhe administrator i vetëm i këtij sistemi, si dhe të pjesëmarrësit në këtë sistem, në përputhje me kushtet e kësaj kontrate dhe Rregullores.



Neni 2

Baza ligjore

Kontrata hartohet në bazë të neneve 659 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe Rregullores së Bankës së Shqipërisë.

Neni 3

Përkufizime dhe interpretime

1. Termat e përdorur në kontratë kanë të njëjtin kuptim me termat e përcaktuar në Rregullore.
2. “Dokumentacioni” është tërësia e rregullave që rregullojnë sistemin AFISaR, ku përfshihen: Rregullorja e Sistemit AFISaR, Manuali i përdorimit të sistemit AFISaR, Manuali SWIFT i sistemit AFISaR.
3. Çdo kusht ose dispozitë e kontratës, që mund të sjellë paqartësi interpretohet në kontekstin e Rregullores dhe në këndvështrimin e qëllimit për të cilin palët lidhin këtë kontratë.
4. Për të gjitha çështjet që nuk përcaktohen shprehimisht në këtë kontratë, zbatohen dispozitat e Rregullores, dhe në rast se këto të fundit nuk rregullojnë çështje të veçanta, zbatohen aktet ligjore dhe nënligjore të fushës të cituara edhe në bazën ligjore të Rregullores.

Neni 4

Kërkesa për aplikim

Kërkesa për aplikim, së bashku me dokumentet e kërkuara sipas Rregullores, të dorëzuara nga Pjesëmarrësi, i bashkëlidhen kontratës dhe janë pjesë përbërëse e saj.

Neni 5

Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja

Kontrata hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët dhe i shtrin efektet e saj për një kohë të pacaktuar.

Neni 6

Mjeti dhe format e komunikimit

1. Për dërgimin/marrjen e instruksioneve të pagesës në lidhje me transaksionet me titujt që regjistrohen dhe shlyhen në sistemin AFISaR, Pjesëmarrësi përdor si mënyrë komunikimi:

a) VPN

b) SWIFT

2. Administratori, pasi aprovon mënyrën e komunikimit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, detajon specifikimet teknike të komunikimit në përputhje me Rregulloren.

Neni 7

Llogaritë

Pjesëmarrësi do të operojë llogaritë e mëposhtme:

- a) Llogari vetjake
- b) Llogari omnibus
- i) Llogari omnibus për persona fizikë
- ii) Llogari omnibus për shoqëri tregtare
- iii) Llogari omnibus për fonde pensioni



Neni 8

Të drejtat dhe detyrimet e palëve

Administratori dhe Pjesëmarrësi kanë të gjitha të drejtat dhe detyrimet që përcaktohen në Rregullore, e cila është e detyrueshme për t'u zbatuar.

Neni 9

Komisionet e pjesëmarrjes

Pjesëmarrësi duhet të paguajë komisionet e përcaktuara në Rregullore për të pasur akses në sistemin AFISaR. Pjesëmarrësi duhet të marrë masat e nevojshme për të përmbushur këtë detyrim pa vonesa kohore.

Neni 10

Konfidencialiteti

Palët angazhohen të ruajnë konfidencialitetin e informacionit të dhënë në mënyrë reciproke, duke bërë përpjekjet maksimale për të minimizuar sa më shumë të jetë e mundur numrin e personave që disponojnë këtë informacion.

Neni 11

Masa administrative

Administratori ka të drejtë të marrë masat e parashikuara në Rregullore, në rast se Pjesëmarrësi nuk e ushtron veprimtarinë në përputhje me Rregulloren, me dokumentacionin, si edhe me instruksionet e dhëna prej tij.

Neni 12

Ndryshimet e kontratës

Kushtet e kontratës ndryshohen me nënshkrimin e të dyja palëve.

Neni 13

Forca madhore

Palët nuk janë përgjegjëse për mospërmbushjen e detyrimeve kontraktore për shkak të forcës madhore, për të cilën njoftojnë menjëherë njëra-tjetrën.

Neni 14

Njoftimet

1. Çdo njoftim, kërkesë ose komunikim tjetër formal ndërmjet palëve, me përjashtim të komunikimit të përcaktuar në nenin 6 të kësaj kontrate, kryhet me postë zyrtare të regjistruar, faks, e-mail, ose në rast pamundësie, kryhet me telefon.

2. Në rast se njoftimi, kërkesa ose komunikimi mbërrin tek i adresuari pas orës 16.30, ai konsiderohet i marrë në orën 08.30 të ditës pasardhëse të punës.

3. Palët njoftojnë njëra-tjetrën për ndryshimet e mundshme të adresave, brenda 5 (pesë) ditsh pune nga ndryshimi i tyre.

4. Palët njoftojnë njëra-tjetrën menjëherë për ndryshimet e mundshme të përfaqësuesve të tyre.

Neni 15

Zgjidhja e kontratës

1. Palët mund të zgjidhin kontratën me mirëkuptim ose në mënyrë të njëanshme për mospërmbushje të detyrimeve të rëndësishme, duke njoftuar me shkrim njëra-tjetrën të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara datës që ato dëshirojnë të zgjidhin kontratën, duke kërkuar plotësimin e detyrimeve financiare të maturuara, të cilat mund të rrjedhin nga kjo kontratë.



2. Për të gjitha rastet e tjera të zgjidhjes së kësaj kontrate që nuk parashikohen në të, zbatohen dispozitat përkatëse të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Neni 16

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin midis palëve në zbatim të kësaj kontrate, dhe që nuk zgjidhen me mirëkuptim, organi kompetent për zgjidhjen e tyre është Gjykata e Tiranës.

Neni 17

E fundit

1. Për pjesëmarrësit rezidentë, kontrata nënshkruhet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe dhe secila nga palët mban një kopje.

2. Për pjesëmarrësit jorezidentë, kontrata nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale: 2 (dy) në gjuhën shqipe, dhe 2 (dy) në gjuhën angleze, dhe secila nga palët mban nga 1 (një) kopje në gjuhën shqipe dhe 1 (një) në gjuhën angleze.

3. Në rast se ka mospërputhje ndërmjet kontratës në gjuhën shqipe dhe asaj në gjuhën angleze, mbizotëron dhe është e detyrueshme kontrata në gjuhën shqipe.

4. Kontrata, pasi lexohet nga palët, nënshkruhet me vullnetin e tyre të lirë e të pavarur.

Për Bankën e Shqipërisë:

Marian Gjermani

Drejtor i Operacioneve Monetare

Për Bankën

SHTOJCA 2

KONTRATA TIP PËR PJESËMARRJEN E TËRTHORTË TË PERSONIT JURIDIK

Kontrata e pjesëmarrjes së tërthortë në Sistemin AFISaR (Albanian Financial Instruments Settlement and Registrations) nëpërmjet Bankës së Shqipërisë

Palët:

Banka e Shqipërisë, në cilësinë Administratorit të sistemit AFISaR dhe Operatorit të llogarisë së pjesëmarrësit të tërthortë në Sistemin AFISaR (më poshtë referuar si “Administratori”), me adresë: sheshi “Skënderbej”, nr. 1, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar në këtë kontratë nga zoti Marian Gjermani, Drejtor i Departamentit të Operacioneve Monetare,

dhe

_____, në cilësinë e pjesëmarrësit të tërthortë (më poshtë referuar si “Pjesëmarrësi”), me adresë zyre në _____, me licencë _____), përfaqësuar në këtë kontratë nga zonja/zoti me numër pasaporte/kartë identiteti _____.

Duke qenë se:

1. Në bazë të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe marrëveshjes ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave, Banka e Shqipërisë është agjent fiskal i Qeverisë;

2. Në bazë të nenit 31 të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas së Republikës së Shqipërisë”, Banka e Shqipërisë, në cilësinë e agjentit fiskal të Qeverisë, krijon, mban sistemin e regjistrimit në llogari për titujt e shtetit, si edhe mbështet krijimin e tregut sekondar të titujve të shtetit, duke lehtësuar përdorimin e sistemit të regjistrimit; dhe

3. Në bazë të nenit 12 të vendimit nr. _____, datë _____2014 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë “Për miratimin e rregullores “Për funksionimin e sistemit qendror të shlyerjes dhe regjistrimit të titujve (AFISaR)” (më poshtë referuar si “Rregullorja”), subjekti që dëshiron të marrë



pjesë në sistemin AFISaR, duhet të lidhë me administratorin kontratën e pjesëmarrjes në sistemin AFISaR;

bien dakord të lidhin këtë kontratë sipas kushteve të mëposhtme.

Neni 1

Objekti

Objekti i kontratës është përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve të Administratorit, të cilat lindin në kuadrin e ofrimit prej tij të shërbimeve të shlyerjes dhe regjistrimit të titujve në sistemin AFISaR, si pronar dhe administrator i vetëm i këtij sistemi dhe në rolin e operatorit të llogarisë së pjesëmarrësit të tërthortë, dhe të pjesëmarrësit të tërthortë në përputhje me kushtet e kësaj kontrate dhe Rregullores.

Neni 2

Baza ligjore

Kontrata hartohet në bazë të neneve 659 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe Rregullores së Bankës së Shqipërisë.

Neni 3

Përkufizime dhe interpretime

1. Termat e përdorur në kontratë kanë të njëjtin kuptim me termat e përcaktuar në Rregullore.
2. Çdo kusht ose dispozitë e kontratës, që mund të sjellë paqartësi interpretohet në kontekstin e Rregullores dhe në këndvështrimin e qëllimit për të cilin palët lidhin këtë kontratë.
3. Për të gjitha çështjet që nuk përcaktohen shprehimisht në këtë kontratë, zbatohen dispozitat e Rregullores, dhe në rast se këto të fundit nuk rregullojnë çështje të veçanta, zbatohen aktet ligjore dhe nënligjore të fushës të cituara edhe në bazën ligjore të Rregullores.

Neni 4

Dokumentacioni

Kërkesa për aplikim, së bashku me dokumentacionin e kërkuar sipas rregullores, të dorëzuara nga Pjesëmarrësi, i bashkëlidhen kontratës dhe janë pjesë përbërëse e saj.

Neni 5

Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja

Kontrata hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët dhe i shtrin efektet e saj për një kohë të pacaktuar.

Neni 6

Mjeti dhe format e komunikimit

1. Për dërgimin/marrjen e instruksioneve të pagesës në lidhje me transaksionet me titujt që shlyen dhe regjistrohen në sistemin AFISaR, Pjesëmarrësi përdor si mënyrë komunikimi urdhrat me shkrim.
2. Urdhrat me shkrim ekzekutohen nga Administratori, duke respektuar oraret e sistemit të përcaktuara në Rregullore.

Neni 7

Llogaria e titullit

1. Administratori hap llogarinë e titullit të pjesëmarrësit në sistemin AFISaR dhe ia njofton Pjesëmarrësit sipas Aneksit 1, pjesë përbërëse e kësaj kontrate.
2. Pjesëmarrësi mund të kërkojë hapjen e më shumë se një llogarie titujsh në të njëjtën monedhë dhe/ose në monedha të ndryshme të përcaktuara nga Administratori.



Neni 8

Agjenti shlyerës

1. Agjenti shlyerës i zgjedhur nga pjesëmarrësi i njoftohet Administratorit sipas Aneksit 2, pjesë përbërëse e kësaj kontrate.

2. Njoftimi për ndryshimin e agjentit shlyerës mund të dërgohet në çdo kohë nga pjesëmarrësi, duke paraqitur aneksin 2, por bëhet efektiv ditën e nesërme të punës në sistemin AFISaR.

Neni 9

Të drejtat dhe detyrimet e palëve

Palët kanë të gjitha të drejtat dhe detyrimet që përcaktohen në Rregullore, e cila është e detyrueshme për t'u zbatuar.

Neni 10

Komisionet e pjesëmarrjes

1. Pjesëmarrësi duhet të paguajë komisionet e përcaktuara në Rregullore për llogarinë e tij në sistemin AFISaR, dhe detyrimet e tjera që lindin nga transaksionet e kryera prej tij pa vonesa kohore.

2. Administratori i sistemit dhe njëkohësisht i operatori i llogarisë së pjesëmarrësit mund t'ia njoftojë Pjesëmarrësit kostot e pjesëmarrjes në mënyrë analitike.

Neni 11

Konfidencialiteti

Palët angazhohen të ruajnë konfidencialitetin e informacionit të dhënë në mënyrë reciproke, duke bërë përpjekjet maksimale për të minimizuar sa më shumë të jetë e mundur numrin e personave që disponojnë këtë informacion.

Neni 12

Personat e autorizuar

Pjesëmarrësi, menjëherë pas nënshkrimit të kontratës, njofton Administratorin për personat e autorizuar, të cilët kanë të drejtë të firmosin urdhra në emër të tij.

Neni 13

Ndryshimet e kontratës

Kushtet e kontratës ndryshohen me nënshkrimin e të dyja palëve.

Neni 14

Forca madhore

Palët nuk janë përgjegjëse për mospërmbushjen e detyrimeve kontraktore për shkak të forcës madhore, për të cilën njoftojnë menjëherë njëra-tjetrën.

Neni 15

Njoftimet

1. Çdo njoftim, kërkesë ose komunikim tjetër formal ndërmjet palëve, me përjashtim të komunikimit të përcaktuar në nenin 6 të kësaj kontrate, kryhet me postë zyrtare të regjistruar, faks, e-mail ose në rast pamundësie, kryhet me telefon.

2. Në rast se njoftimi, kërkesa ose komunikimi mbërrin tek i adresuari pas orës 16.30, ai konsiderohet i marrë në orën 08:30 të ditës pasardhëse të punës.

3. Palët njoftojnë njëra-tjetrën për ndryshimet e mundshme të adresave, brenda 5 (pesë) ditësh pune nga ndryshimi i tyre.



4. Palët njoftojnë njëra-tjetrën menjëherë për ndryshimet e mundshme të përfaqësuesve të tyre.

Neni 16

Zgjidhja e kontratës

1. Palët mund të zgjidhin kontratën, me mirëkuptim ose në mënyrë të njëanshme, për mospërbushje të detyrimeve të rëndësishme, duke njoftuar me shkrim njëra-tjetrën të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara datës që ato dëshirojnë të zgjidhin kontratën, duke kërkuar plotësimin e detyrimeve financiare të maturuara, të cilat mund të rrjedhin nga kjo kontratë.

2. Për të gjitha rastet e tjera të zgjidhjes së kësaj kontrate që nuk parashikohen në të, zbatohen dispozitat përkatëse të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Neni 17

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Për të gjitha mosmarrëveshjet, që mund të lindin midis palëve në zbatim të kësaj kontrate, dhe që nuk zgjidhen me mirëkuptim, organi kompetent për zgjidhjen e tyre është Gjykata e Tiranës.

Neni 18

E fundit

1. Për pjesëmarrësit rezidentë, kontrata nënshkruhet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe dhe secila nga palët mban një kopje.

2. Për pjesëmarrësit jorezidentë, kontrata nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale: 2 (dy) në gjuhën shqipe dhe 2 (dy) në gjuhën angleze, dhe secila nga palët mban nga 1 (një) kopje në gjuhën shqipe dhe 1 (një) në gjuhën angleze.

3. Në rast se ka mospërputhje ndërmjet kontratës në gjuhën shqipe dhe asaj në gjuhën angleze, mbizotëron dhe është e detyrueshme kontrata në gjuhën shqipe.

4. Kontrata, pasi lexohet nga palët, nënshkruhet me vullnetin e tyre të lirë e të pavarur.

Për Bankën e Shqipërisë:

Marian Gjermani

Drejtore i Operacioneve Monetare

Për Bankën



ANEKSI 1
LLOGARIA E TITULLIT NË SISTEMIN AFISAR

1. Llogaria/llogaritë e titullit në ALL:

2. Llogaria/llogaritë e titullit në valutë:

Monedha	<input type="text"/>	<input type="text"/>
Monedha	<input type="text"/>	<input type="text"/>
Monedha	<input type="text"/>	<input type="text"/>

Nënshkrimi nga përfaqësuesi i Bankës së Shqipërisë

ANEKSI 2
AGJENTI SHLYERËS

Agjent shlyerës në për transaksione në ALL

është Banka* _____

Llogaria pranë agjentit shlyerës nr. _____

Agjent shlyerës për transaksionet në valutë:

Në monedhën _____

është Banka* _____

Llogaria pranë agjentit shlyerës nr. _____

Nënshkrimi nga përfaqësuesi ligjor i pjesëmarrësit/vula

*Llogaritë e mësipërme janë të vërtetuara me vërtetimet bashkëngjitur, të lëshuara nga Agjenti shlyerës.



SHTOJCA 3 KONTRATA TIP PËR PJESËMARRJEN E TËRTHORTË TË PERSONIT FIZIK

Kontratë ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe individit klient i sportelit të saj

Palët:

Banka e Shqipërisë (më poshtë, për thjeshtësi: “Banka”), e përfaqësuar ligjërisht në këtë kontratë nga: Marian Gjermani, drejtor i Departamentit të Operacioneve Monetare:

dhe

Personi fizik (si më poshtë për thjeshtësi: “individ”) _____, me kartë identifikimi (ose pasaportë biometrike) numër _____,

me adresë _____;

bien dakord të lidhin këtë kontratë sipas kushteve të mëposhtme.

Neni 1

Baza ligjore

Kjo kontratë lidhet në bazë dhe për zbatim të akteve të mëposhtme:

- a) ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- b) Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë;
- c) ligjit “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas së Republikës së Shqipërisë”;
- d) rregullores së Bankës së Shqipërisë “Për funksionimin e sistemit qendror të regjistrimit dhe shlyerjes së titujve (AFISaR)”;
- e) legjislacionit tatimor; dhe
- f) akteve të tjera nënligjore të Bankës së Shqipërisë.

Neni 2

Qëllimi

Kontrata synon të rregullojë marrëdhënien për hapjen, ruajtjen, mirëmbajtjen e llogarisë(ve) të titullit nga individit në sistemin AFISaR të Bankës, me qëllim realizimin e investimit në tregun primar të bonove të thesarit (Lekë) të Qeverisë nëpërmjet sporteleve të Bankës.

Neni 3

Përkufizime

- a) “Llogari titull” – llogari e hapur në sistemin AFISaR, me qëllimin e pasqyrit të lëvizjeve në gjendjen e bonos së thesarit të zotëruar nga individit.
- b) “Llogari cash” – është llogaria e hapur në bankën tregtare ku pasqyrohen lëvizjet e fondeve të individit që lidhen me veprimet e kryera për investimin e tyre në bonot e thesarit.
- c) “Individ” – është personi fizik me zotësi të plotë juridike që investon në bono thesari në tregun primar pranë sporteleve të Bankës.
- d) “Qeveria” – është Qeveria e Republikës së Shqipërisë.
- e) “Banka” – është Banka e Shqipërisë.
- f) “Tregu primar” – është tregu në të cilin shiten për herë të parë titujt e Qeverisë.
- g) “Ankandi” – është ankandi i zhvilluar në Bankë për shitjen e bonove të thesarit të emetuara nga Qeveria.
- h) “Bonot e thesarit” – janë tituj afatshkurtër të emtuar nga Qeveria, që shiten me zbritje dhe vlera nominale e të cilave paguhet në ditën e maturimit.
- i) “Emetuesi i bonove të thesarit” – është Ministria e Financave në emër të Qeverisë.
- j) “Sistemi i shlyerjes dhe regjistrimit të titujve (AFISaR)” - nënkupton sistemin që krijon dhe mban Banka për regjistrimin dhe shlyerjen e titujve të emtuar nga Qeveria.



k) “Prorata” - raporti i shumës së paracaktuar për kërkesat jokonkuruese të individëve kundrejt shumës totale të kërkesave jokonkuruese të paraqitura në ankand nga individët.

Neni 4

Llogaria e titullit

1. Llogaria e titullit shërben për kryerjen e veprimeve të mëposhtme:

- a) reflektimin e veprimit të blerjes së bonove të thesarit nga individë në tregun primar në ditën e emetimit të ankandit;
- b) reflektimin e veprimit të maturimit të bonos së thesarit në ditën e maturimit të saj;
- c) reflektimin e veprimit të transferimit të bonos së thesarit në një llogari titulli të personit fizik të hapur në një bankë tregtare; dhe
- d) reflektimin e veprimit të shitjes së bonos së thesarit nga individë në tregun sekondar.

Neni 5

Llogari e cash-it

1. Llogari e cash-it që do pasqyrojë veprimet e individit me bonot e thesarit duhet të jetë në një nga bankat tregtare me të cilat Banka ka kontratë për këtë shërbim.

2. Individë paraqet informacionin mbi bankën tregtare në të cilën ka llogarinë e cash-it. Informacioni duhet të përmbajë detajet e mëposhtme:

- a) emrin e bankës tregtare; dhe
- b) numrin e llogarisë së cash-it në formën IBAN.

3. Veprimet, të cilat pasqyrohen në llogarinë e cash-it të individit në bankën tregtare janë:

- a) diferenca e vlerës nominale me çmimin e blerjes së bonos së thesarit;
- b) shuma e mbetur pa u investuar në rastin e proratës;
- c) kalimi i vlerës së maturuar të bonos së thesari, pas deduktimit të tatimit mbi interesin.

4. Njoftimi për ndryshimin e numrit të llogarisë së cash-it dhe/ose për bankën tregtare mund të dërgohet në çdo kohë, por bëhet efektiv për kryerjen e veprimeve në ditën e nesërme të punës në sistemin e Bankës.

Neni 6

Mjeti dhe format e komunikimit

1. Individë urdhëron prekjen e llogarisë(ve) të tij të titullit dhe pjesëmarrjen në ankandet e bonove të thesarit nëpërmjet urdhrave me shkrim të paraqitura në njërin prej sporteleve të Bankës.

2. Individë mund të paraqitet në çdo sportel të Bankës për të kryer veprimet, pavarësisht se në cilin sportel e ka hapur llogarinë.

3. Urdhrrat me shkrim ekzekutohen nga Banka, duke respektuar oraret e sistemit AFISaR, të përcaktuara në Rregulloren e sistemit.

Neni 7

Veprimet që nuk ofrohen

Banka nuk kryen veprimet e mëposhtme për individët:

- e) vendosjen si garanci apo kolateral të bonos së thesarit të zotëruar nga individë, sipas gjendjes në llogarinë e tij të titullit;
- f) transferimin e gjendjes së llogarisë së tij të titullit të hapur në bankë tregtare, për në llogarinë e tij të titullit të hapur në Bankë;
- g) transferimin e gjendjes në llogarinë e titullit të individit në një llogari në Bankë apo në bankë tregtare me emër të ndryshëm nga ajo e individit, përveç rasteve të urdhëruara nga organet gjyqësore;
- h) hapjen e llogarive të titullit me më shumë se një emër; dhe
- i) çdo veprim tjetër që nuk është i përmendur në nenet 4 dhe 5.



Neni 8

Detyrimet e Bankës

Në marrëdhënie me individin, Banka ka detyrimet e mëposhtme:

- a) të hapë, të ruajë, të mirëmbajë dhe të përdorë sipas funksioneve të përcaktuara në nenin 4, llogarinë(të) e titullit;
- b) të klerojë dhe shlyejë çdo transaksion të urdhëruar nga individit për veprimet e lejuara me llogaritë e tij, sipas përcaktimeve në nenin 4;
- c) t'i japë informacion individit për investimin në bonot e thesarit, si dhe t'i verë në dispozicion broshurën informative mbi investimin në bonot e thesarit;
- d) t'i japë informacion individit për listën e bankave tregtare me të cilat ka kontratë për hapjen e llogarisë së cash-it nga individët;
- e) të informojë individin për kushtet e punës për hapjen e llogarisë(ve) sipas aneksit 1 “Kushtet e përgjithshme të punës”;
- f) të ruajë konfidencialitetin e të dhënave të individit, si dhe informacionin mbi llogaritë e tij, përveç rasteve kur informacioni mbi këto të dhëna jepet me pëlqimin e individit, ose është kërkuar nga gjykata, prokuroria ose çdo autoritet tjetër që ka kompetencën ligjore për marrjen e këtij lloji informacioni;
- g) të sigurojë sisteme informative të përshtatshme për ruajtjen, sigurimin dhe administrimin e të dhënave elektronike për individin; dhe
- h) të ruajë në një vend të sigurt dokumentacionin origjinal të përdorur për regjistrimin e të dhënave të individit, apo urdhrat e tij për prekjen e llogarive, sipas procedurave dhe afateve kohore të përcaktuara në ligjet dhe aktet nënligjore përkatëse.

Neni 9

Detyrimet e individit

Në marrëdhënie me Bankën, individit ka detyrimet e mëposhtme:

- a) të japë informacionin e saktë të kërkuar për hapjen e llogarisë(ve) të tij pranë Bankës, si dhe të informojë Bankën për ndryshime të këtij informacioni;
- b) të japë informacion të verifikuar me dokumente përkatëse, në rast se ka status të veçantë, të cilit i ofrohet lehtësi fiskale në bazë të legjislacionit tatimor;
- c) të njihet me instrumentin e bonove të thesarit, duke pyetur punonjësit e Bankës, duke lexuar broshurën informative, ose nga burime të tjera; dhe
- d) të paguajë komisionet e Bankës, nëpërmjet bankës tregtare ku ka llogarinë e cash-it, për shërbimin e ofruar në përputhje me kushtet e punës, të njohura dhe të nënshkruara prej tij sipas Aneksit të kontratës.

Neni 10

Të drejtat e individit

Në marrëdhënie me Bankën, individit ndër të tjera, ka të drejtat e mëposhtme:

- a) të kërkojë informacion apo vërtetime mbi gjendjet e llogarisë(ve) të tij të titullit;
- b) të kërkojë informacion për njohjen me investimin në bono thesari; dhe
- c) të autorizojë një individ tjetër, nëpërmjet prokurës, për të kryer veprime me llogaritë e tij.

Neni 11

Përgjegjësia nga përgjegjësia

Banka nuk është përgjegjëse:

- a) për mospërbushje të detyrimeve kontraktore për shkak të forcës madhore; dhe
- b) për dëmet e shkaktuara ndaj individit nga Emetuesi i bonove të thesarit.



Neni 12

Ndryshimet e kontratës

1. Banka ka të drejtë të ndryshojë kushtet e kontratës dhe të njoftojë me shkrim ose me mjete të tjera komunikimi individin.
2. Çdo ndryshimi i kontratës nga ana e Bankës bëhet efektiv pas nënshkrimit të kontratës nga të dyja palët.

Neni 13

Njoftimet

1. Çdo njoftim ndërmjet palëve, kryhet me postë zyrtare të regjistruar, faks, e-mail, ose në rast pamundësie, kryhet me telefon.
2. Palët njoftojnë njëra-tjetrën për ndryshimet e mundshme të adresave brenda 5 (pesë) ditësh pune nga ndryshimi i tyre.

Neni 14

Zgjidhja e kontratës

1. Individit mund të zgjidhë kontratën në mënyrë të njëanshme, duke njoftuar me shkrim Bankën. Në këtë rast, ai paraqitet pranë Sportelit për të nënshkruar urdhrin për transferimin e gjendjes së llogarisë(ve) të tij.
2. Banka mund të zgjidhë kontratën në mënyrë të njëanshme, duke njoftuar individin të paktën 30 (tridhjetë) ditë përpara, dhe duke ofruar kushte për kalimin e gjendjes në llogarinë(të) e tij, sipas urdhrave të individit.
3. Me zgjidhjen e kontratës, Banka mbyll të gjitha llogaritë e individit.
4. Për të gjitha rastet e tjera të zgjidhjes së kontratës, që nuk parashikohen në këtë kontratë, zbatohen dispozitat përkatëse të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Neni 15

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet palëve në zbatim të kontratës dhe që nuk zgjidhen me mirëkuptim, organi kompetent për zgjidhjen e tyre është Gjykata e Tiranës.

Neni 16

Adresat

Adresat e Sporteleve të Bankës janë si më poshtë vijon:

1. për Sportelin e Tiranës: Sheshi “Avni Rustem”, nr. 24, Tiranë;
2. për Sportelin e Elbasanit: Lagjia “28 Nëntori”, rruga “11 Nëntori”, pranë prefekturës Elbasan, Elbasan;
3. për Sportelin e Korçës: Bulevardi “Gjergj Kastrioti”, Korçë;
4. për Sportelin e Shkodrës: Lagjia “Qemal Stafa”, Rruga “13 Dhjetori”, pranë prefekturës Shkodër, Shkodër;
5. për Sportelin e Lushnjës: Lagjia “Kongresi i Lushnjës”, prapa Bashkisë Lushnjë, Lushnjë;
6. për Sportelin e Gjirokastrës: Lagjia “18 Shtatori”, Rruga “18 Shtatori”, Gjirokastrë. Lagjia “Varosh”, pranë Qarkut Gjirokastrë, Gjirokastrë.

Neni 17

E fundit

1. Kontrata përpilohet në 2 (dy) kopje në gjuhën shqipe, nga të cilat 1 (një) kopje e mban Banka dhe 1 (një) kopje e mban individit.



2. Kontrata, pasi lexohet nga palët, nënshkruhet me vullnetin e tyre të lirë e të pavarur.

Për Bankën e Shqipërisë:

Marian Gjermeni

Drejtor i Operacioneve Monetare

Individi: _____

Z/Zj. _____

ANEKS 1 KUSHTET E PËRGJITHSHME TË PUNËS

Banka ka kushtet e punës së mëposhtme për ofrimin e shërbimit ndaj individëve:

1. nuk bëhet asnjë veprim me cash në sportelet e Bankës;
2. komisioni për ndërmjetësimin e kërkesës së individit për në ankandin e bonove të thesarit është 0 (zero) lekë;
3. komisioni për hapjen dhe mirëmbajtjen e llogarisë së titullit është 0 (zero) lekë;
4. komisioni për transfertat për në bankat tregtare është 0 (zero) lekë
5. transfertat nga llogaritë e individit klerohen dhe shlyhen jo më vonë se 2 (dy) ditë pune pas marrjes së urdhrit nga individit.

SHTOJCA 4

Kontrata për shlyerjen e transaksioneve në cash që gjenerohen nga veprimet me tituj të personave fizikë që e kanë llogarinë e titullit në Bankën e Shqipërisë

Palët:

Banka e Shqipërisë (më poshtë referuar si “BSH”) me adresë: Sheshi “Skënderbej”, nr. 1, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar në këtë kontratë nga zoti Marian Gjermeni, Drejtor i Departamentit të Operacioneve Monetare,

dhe

_____, (më poshtë referuar si “Banka”) me adresë zyre në _____, me Licencë _____), përfaqësuar në këtë kontratë nga zonja/zoti _____ me numër pasaporte/kartë identiteti;

bien dakord të lidhin këtë kontratë sipas kushteve të mëposhtme.

Neni 1

Objekti

Objekti i kësaj kontrate është rregullimi i marrëdhënieve midis palëve duke përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e tyre në procesin e shlyerjes së cash-it nga veprimet e kryera në treg primar nga personat fizikë, të cilët kanë llogarinë e titullit në Sportelin e BSH-së.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo kontratë hartohet në bazë të neneve 659 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe të Rregullores së Bankës së Shqipërisë “Për funksionimin e sistemit qendror të regjistrimit dhe të shlyerjes së titujve (AFISaR)”.

Neni 3

Përkufizime

1. Në zbatim të kësaj kontrate, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

- a) Klient – është personi fizik që merr pjesë në ankandin e tregut primar të emetimit të bonove të thesarit të shtetit shqiptar nëpërmjet Sportelit të BSH-së;



b) Bono thesari – janë tituj afatshkurtër, emetimi i të cilave rregullohet me udhëzimin për emetimin nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë e bonove të thesarit në formë regjistrimi dhe në Marrëveshjen midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave për “Organizimin e ankandeve të titujve të shtetit shqiptar, shlyerjen e veprimeve dhe mbajtjen e regjistrit të këtyre titujve”;

c) FTP (File transfer protocol) - është një protokoll rrjeti standard që përdoret për të transferuar skedarë nga një kompjuter në një tjetër, mbi një rrjet me bazë TCP, të tillë si Interneti;

d) Rakordimi – është krahasimi i të dhënave të dërguara nga bankat, të prodhuara në mënyrë automatike nga sistemet e tyre, me të dhënat e prodhuara nga sistemi AFISaR i BSH-së;

e) Procesi – në kontekstin e përdorur në këtë kontratë, përbëhet nga hapat e mëposhtëm:

i) bllokimi i shumës nga personi fizik në bankë,

ii) regjistrimi në sistemin AFISaR i kërkesës së klientit për pjesëmarrjen në ankand nga BSH-ja,

iii) shlyerja e veprimeve në cash që gjenerohet nga pjesëmarrja e klientit në ankandin e tregut primar (emetim/maturim i titullit);

f) Titull – në kontestin e përdorur në këtë kontratë i referohet vetëm bonove të thesarit;

g) Vlera neto e cash-it – është rezultati i veprimeve për emetimin dhe maturimin e titujve që ndodhin në të njëjtën ditë shlyerje;

h) Person fizik – është individ i me zotësi të plotë juridike;

i) Organe kompetente - përshijnë, gjykatën, prokurorinë, organet e tatimeve dhe të tjera që kanë të drejtë me ligj për të vendosur bllokim të llogarive.

2. Për termat e tjerë, palët u referohen termave dhe qëllimit të Rregullores së Sistemit AFISaR, si dhe legjislacionit përkatës të fushës.

Neni 4

Regjistrimi i kërkesës

1. Personi fizik paraqitet në një nga degët e bankës dhe kërkon bllokimin e shumës për ankandin për emetimin e bonos së thesarit që dëshiron, duke kryer të gjitha procedurat e nevojshme sipas specifikimeve të bankës.

2. Personi fizik paraqitet në një nga Sportelet e BSH-së dhe shpreh vullnetin për të marrë pjesë në ankandin për emetimin e bonos së thesarit që dëshiron. Në të njëjtën kohë, paraqet edhe numrin e llogarisë së cash-it në bankën tregtare nëpërmjet të cilës do shlyhen veprimet për blerjen e bonos së thesarit.

3. Të dhënat me të cilat personi fizik regjistrohet në bankë dhe në BSH paraqiten sipas Aneksit 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj kontrate.

Neni 5

Rakordimi i të dhënave

1. Rakordimi i të dhënave bëhet nga BSH-ja.

2. Banka dërgon skedarin e të dhënave të përpiluar sipas formatit që përshkruhet në aneksin 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj kontrate.

3. Dërgimi i skedarit bëhet nga banka 1 (një) ditë pune përpara ditës së zhvillimit të ankandit në orën 09:30. Pas kësaj ore banka nuk mund të shtojë apo ndryshojë të dhënat, përveç rasteve të korigjimit të gabimeve që dalin nga rakordimi.

4. Në rast se ka diferenca nga procesi i rakordimit, BSH-ja komunikon me bankën për sqarimin e diferencave deri në orën 12:00 të ditës së punës përpara ditës së zhvillimit të ankandit. Në orën 16:00 kryhet rakordimi final. Në rast se nuk ka diferenca, BSH-ja konfirmon rakordimin e të dhënave.

5. Në rast se rakordimi final sipas pikës 4 nuk rezulton i plotë, BSH-ja nuk i paraqet në ankand kërkesat e personave fizikë, për të cilët nuk arrihet rakordimi. BSH-ja njofton bankën dhe klientët për mospranimin e kërkesave të tyre.



Neni 6 Shlyerja

1. Në ditën e shlyerjes së ankandit, BSH-ja debiton/krediton automatikisht llogarinë e bankës në sistemin AIPS për vlerën neto të cash-it për veprimet me tituj të secilit prej klientëve të saj.
2. Banka proceson automatikisht këto veprime, duke prekur llogaritë respektive të klientëve, jo më vonë se dita e shlyerjes së ankandit.
3. BSH-ja ka të drejtë të kryejë auditime të procesit të shlyerjes automatike në bankë sipas pikës 2, sa herë që e gjykon të arsyeshme.

Neni 7 Gabimet

1. Në rast se gjatë procesit të shlyerjes automatike pranë bankës, konstatohen gabime të transaksioneve të emetimit të titujve, të cilat nuk mund të ndreqen dhe, në këto kushte, mund të rezultojnë në përfitim të padrejtë të titullit nga personi fizik ndaj të cilit është bërë gabimi, atëherë vepohet si më poshtë:
 - a) Banka e merr titullin në pronësi të saj. Për këtë kryhen instruksionet e pagesave përkatës në sistemin AFISaR për transferimin FoP në përputhje me rregulloren e sistemit AFISaR;
 - b) në rast të pamundësisë së argumentuar për marrjen në pronësi të titullit, atëherë ky i fundit kalon në llogarinë vetjake të titullit të Ministrisë së Financave, pasi është rënë dakord me këtë të fundit për kthimin e çmimit të titullit në llogarinë e bankës. Veprimet kryhen në sistemin AFISaR në përputhje me rregulloren e sistemit.
2. Në rast se gjatë procesit të shlyerjes automatike, pranë bankës të transaksioneve të maturimit të titujve konstatohen gabime, të cilat nuk mund të ndreqen brenda periudhës së përcaktuar për investigim në Rregulloren e sistemit AIPS të BSH-së, banka ja kthen BSH-së këtë pagesë sipas instruksioneve të dhëna nga kjo e fundit.

Neni 8 Urdhër bllokimet

- Në rast se organet kompetente dërgojnë urdhër për bllokimin e llogarive të personit fizik gjatë kohës që ka nisur procesi, atëherë bllokimi bëhet si më poshtë:
- a) në rast se urdhri mbërrin në institucionin përkatës përpara rakordimit final sipas nenit 5, pika 4, bllokimin e bën banka duke njoftuar menjëherë BSH-në për bllokimin e këtij klienti. BSH-ja çregjistron kërkesën e personit fizik dhe bëhet rakordimi final.
 - b) në rast se urdhri mbërrin në institucionin përkatës pas rakordimit final, bllokimin e bën BSH-ja duke bllokuar llogarinë e titullit të klientit. BSH-ja njofton menjëherë bankën pas marrjes së urdhrit.

Neni 9 Tatimi

Tatimi në burim për interesin në ditën e maturimit të titullit, nëse ka të tillë, mbahet nga BSH-ja.

Neni 10 Mjeti dhe format e komunikimit

1. Mënyra e komunikimit për shkëmbimin e skedarit është nëpërmjet transferimit të fileve FTP. Shërbimi FTP aksesohet dhe operon vetëm në rrjetin e sigurt VPN.
2. Mënyra e dërgimit të njoftimit për shlyerjen e veprimeve është nëpërmjet MT900 dhe MT910.
3. Komunikimi për sqarimin e diferencave që dalin gjatë rakordimit, ose njoftimet për bllokimet sipas nenit 8, bëhen me telefon dhe/ose e-mail zyrtar. Për bllokimet sipas nenit 8, dërgohet edhe shkresë zyrtare.



Neni 11
Njoftimet

Në rast se palët kanë ndryshime në mënyrën dhe teknologjinë e sistemeve me të cilat realizohet procesi, ato njoftojnë njëra-tjetrën të paktën 3(tre) muaj përpara ndryshimeve.

Neni 12
Detyrimet ndaj klientit

1. BSH-ja përgjigjet ndaj personit fizik, klient i saj, për të gjitha të drejtat dhe detyrimet që ka ndaj tij, të shprehura në kontratën e lidhur me të për llogarinë e titullit.

2. Banka përgjigjet ndaj personit fizik për të gjitha të drejtat dhe detyrimet që ka ndaj tij të shprehura në kontratën e lidhur me të për llogarinë e cash-it.

Neni 13
Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja

Kontrata hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët dhe i shtrin efektet e saj për një kohë të pacaktuar.

Neni 14
Zgjidhja e kontratës

1. Palët mund të zgjidhin kontratën me mirëkuptim, ose në mënyrë të njëanshme për mospërbushje të detyrimeve të rëndësishme, duke njoftuar me shkrim njëra-tjetrën të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara datës që ato dëshirojnë të zgjidhin kontratën.

2. Për të gjitha rastet e tjera të zgjidhjes së kësaj kontrate që nuk parashikohen në këtë kontratë, zbatohen dispozitat përkatëse të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Neni 15
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin midis palëve në zbatim të kësaj kontrate që nuk zgjidhen me mirëkuptim, organi kompetent për zgjidhjen e tyre është Gjykata e Tiranës.

Neni 16
Të fundit

1. Kontrata përpilohet në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe, nga të cilat 2 (dy) kopje i mban BSH-ja dhe 2 (dy) kopje i mban banka.

2. Kontrata, pasi lexohet nga palët, nënshkruhet me vullnetin e tyre të lirë e të pavarur.

Për Bankën e Shqipërisë:
Marian Gjermani

Për Bankën: _____

Drejtore i Operacioneve Monetare



ANEKSI 1
TË DHËNAT E PERSONIT FIZIK

Emër/Mbiemër _____

Numri i kartës së indentitetit _____

Datëlindja _____

Tatimi në burim: Po Jo

Në qoftë se “Po”, norma e taksës në përqindje _____

Rezidenca: Rezident Jorezident

Adresa: _____

E-maili zyrtar: _____

Tel: _____

ANEKSI 2
TË DHËNAT E SKEDARIT

Nr.	Përshkrimi	Tipi	Komente
1	Kodi i bankës Swift	String(8) ose String (11)	Kodi i bankës tregtare në SWIFT
2	Unique Ref Number	String (50)	Numri unik që identifikon transaksionin e bllokimit të shumës në core banking system. Do t'i shërbejë bankës për të identifikuar transaksionin, në rast mospërputhje gjatë rikoncilimit
3	Datë raportimi	Datë (yyyy-mm-dd tt:mm:ss)	Data dhe ora e raportimit të të dhënave
4	Datë emetimi	Datë (yyyy-mm-dd)	Data e shlyerjes (data e emetimit të ankandit)
5	Lloj ankandi	String (2)	Kodi për: BTh 3-mujore (3M) BTh 6-mujore (6M) BTh 12-mujore (1Y)
6	IBAN	String (28)	Iban i llogarisë rrjedhëse të individit në bankë
7	Emri	String (50)	Emri i individit
8	Mbiemri	String (50)	Mbiemri i individit
9	Numri Unik i Identifikimit	String(50)	Numri personal i klientit, i përkufizuar në kartën e indentitetit ose në pasaportën biometrike
10	Shuma	Float (max 13; 11 digits plus 2 decimals)	Shuma e ndarë për lloj ankandi. Shuma është e shprehur me dy shifra pas presjes, e pandarë

Për çdo shumë të bllokuar nga personi fizik në bankë, banka duhet të raportojë një rresht në skedarin tekst, sipas udhëzimeve në Tabelën 1. Banka duhet të ketë kujdes që të raportojë rreshta të ndryshëm në rastet kur i njëjti klient merr pjese në shumë ankande.



SHTOJCA 5 RADHËT PRITËSE DHE STATUSI I TRANSAKSIONIT

1. Radhët pritëse

Në shlyerjen e veprimeve me tituj, instruksionet e dërguara nga pjesëmarrësit mbahen sipas rastit, në radhët pritëse si më poshtë:

I. Radha në “Pritje për përputhje”

Radha “Pritje për përputhje” përmban mesazhe që duhen përputhur dhe që nuk e kanë arritur akoma këtë status. Një proces automatik skanimi për radhën e pritjes kryhet brenda sistemit, përgjatë gjithë ditës, me qëllim që të bëjë përputhjen për mesazhet që kanë nevojë për përputhje.

II. Radha “Pritje për titujt”

Radha “Pritje për titujt” përmban transaksionet, për të cilat titujt e disponueshëm në llogarinë e titujve të shitësit nuk janë të mjaftueshëm për të përfunduar shlyerjen. Rregulli për menaxhimin e radhës është FIFO. Transaksionet radhiten për çdo pjesëmarrës në varësi të kohës kur kanë hyrë në sistem dhe në varësi të prioritetit të caktuar nga sistemi. Kohë e hyrjes në sistem do të konsiderohet koha kur sistemi cakton kodin unik.

Ekzistojnë dy prioritete, si më poshtë:

a) prioriteti 0: për veprimet ndërmjet pjesëmarrësit dhe bankës qendrore;

b) prioriteti 99: për veprimet midis pjesëmarrësve.

III. Radha “Pritje për konfirmimin e fondeve”

Radha “Pritje për konfirmimin e fondeve” përmban transaksionet në pritje për konfirmim për:

a) shlyerjen e fondeve në ALL nga sistemi AIPS;

b) shlyerjen e transaksioneve në tregun primar në valutë nga sistemi LORO;

c) konfirmimin nga shitësi për shlyerjen e transaksioneve në tregun sekondar në valutë.

IV. Radha “Pritje për nisje në një kohë të mëvonshme”

Radha “Pritje për nisje në një kohë të mëvonshme” përmban informacion rreth veprimeve që përfshijnë ekzekutimin, në një kohë të mëvonshme të:

a) hapit të dytë të transaksioneve repo;

b) transaksionet që kanë një datë valutë të mëvonshme nga data e hyrjes së transaksioneve në sistem.

Mesazhet radhiten në radhën pritëse dhe procesohen nga sistemi në varësi të orës/datës së caktuar për shlyerje dhe në varësi të kohës kur kanë hyrë në sistem.

V. Radha “Pritje për autorizim”

Radha “Pritje për autorizim” përmban transaksionet që përfshijnë një llogari me status “të kufizuar”.

VI. Radha “Pritje për tavanin e shlyerjes”

Radha “Pritje për tavanin e shlyerjes” përmban transaksionet shumë e të cilave kalojnë kufirin e fondeve të disponueshme për pjesëmarrësit pa llogari shlyerjeje në RTGS, për të cilët sistemi menaxhon tavanin e shlyerjes.

Transaksioni mbahet në radhën e pritjes deri sa tavanin e shlyerjes së pjesëmarrësit arrin shumën e nevojshme për shlyerje ose deri në orarin e cut-off për shërbimin respektiv, kur të gjitha transaksionet të mbajtura në radhë pritjeje anulohen nga sistemi dhe pjesëmarrësve i dërgohet njoftim.

2. Statusi i transaksionit

Përkrah radhëve të përshkruara më sipër, një transaksion merr statuset e mëposhtme:

I. “I përfunduar” - që do të thotë që shlyerja e transaksionit ka përfunduar;

II. “I anuluar” - që do të thotë që transaksioni është anuluar. Transaksionet mund të marrin këtë status kur sistemi anulon automatikisht transaksionet që janë në radhët pritëse I, II, III dhe VI në cut-off e shërbimit përkatës, ose kur kërkohet nga vetë pjesëmarrësi dhe transaksioni është ende në fazën ku sistemi e pranon anulimin e iniciuar nga pjesëmarrësi;

III. “I refuzuar” - që do të thotë që sistemi nuk e ka pranuar instruksionin e pagesës;

IV. “Në pritje për përgjigje nga RTGS” - që do të thotë që ndërveprimi i dy sistemeve AFISaR dhe AIPS ose AFISaR dhe LORO nuk ka ndodhur ende;



V. “Në pritje për lirim nga RTGS” - që do të thotë që sistemi respektiv i shlyerjes AIPS ose LORO nuk i ka dërguar ende përgjigje AFISaR për kërkesën e tij për anulimin e transaksioneve në cut-off të shërbimit përkatës.

SHTOJCA 6 LLOJET E MESAZHEVE DHE NJOFTIMEVE

1. Mesazhet hyrëse

Tipi i mesazhit	Përshkrimi
MT 540	Instruksion për marrjen e një instrumenti FOP. Përdoret edhe për anulimin e instruksionit.
MT 541	Instruksion për marrjen e një instrumenti DVP. Përdoret edhe për anulimin e instruksionit.
MT 542	Instruksion për dorëzimin e një instrumenti FOP. Përdoret edhe për anulimin e instruksionit.
MT 543	Instruksion për dorëzimin e një instrumenti DVP. Përdoret edhe për anulimin e instruksionit.
MT 527	Instruksion në lidhje me kolateralin
MT 910	Konfirmim kreditimi

2. Mesazhet njohëse dhe njoftuese

Sistemi përdor mesazhet SWIFT për të konfirmuar ekzekutimin e instruksioneve të pagesës ose për të paralajmëruar dështimet dhe rrethanat e jashtëzakonshme. Tipat e mesazheve janë si në vijim:

a) Mesazhet konfirmuese

Tipi i mesazhit	Përshkrimi
MT 544	Konfirmon marrjen e një instrumenti në një transaksion FOP. Mund të përdoret për anulimin e instruksionit ose kryerjen e veprimit të anasjelltë.
MT 545	Konfirmon marrjen e një instrumenti në një transaksion DVP. Mund të përdoret për anulimin e instruksionit ose kryerjen e veprimit të anasjelltë.
MT 546	Konfirmon dorëzimin e një instrumenti në transaksionin FOP. Mund të përdoret për anulimin e instruksionit ose kryerjen e veprimit të anasjelltë.
MT 547	Konfirmon dorëzimin e një instrumenti në transaksionin DVP. Mund të përdoret për anulimin e instruksionit ose kryerjen e veprimit të anasjelltë.
MT 558	Njoftim në lidhje me kolateralin

b) Mesazhet njoftuese

Tipi i mesazhit	Përshkrimi
MT 599	Mesazh përshkrues
MT 548	Njoftimi për përputhjen e instruksioneve (gjenerohet automatikisht nga sistemi, por mund të zgjidhet edhe mos marrja e këtij mesazhi) Njoftimi për refuzimin e instruksionit ku përfshihet edhe arsyeja e refuzimit

3. Kriteret e përputhshmërisë

Për instruksionet e pagesave, të cilat hyjnë në sistem nëpërmjet workstation dhe i nënshtrohen procedurës së përputhjes, AFISaR validon automatikisht kriteret e mëposhtme të përputhshmërisë:

1. lloji i mesazhit;

2. agjenti që e dorëzon titullin;

3. agjenti që e merr titullin;

4. lloji i llogarisë nga dorëzohet titulli (lloji i llogarisë i nënshtrohet përputhjes vetëm në rast se është në të dy mesazhet);



5. lloji i llogarisë nga merret titulli;
6. data e shlyerjes;
7. çmimi;
8. ISIN;
9. vlera nominale e titullit.

4. Alertet

Nr.	Natyra e alertit	Lloji i alertit
1	Informativ	Lajmërim për krijimin e informacionit të ankandit
2	Informativ	Lajmërim për ekzekutimin e informacionit të ankandit
3	Informativ	Lajmërim për ndryshimin e informacionit të ankandit
4	Informativ	Lajmërim për anulimin e informacionit të ankandit
5	Gabim	Lajmërim për bllokim të përdoruesit
6	Informativ	Lajmërim për mesazhe të dështuara
7	Informativ	Lajmërim për transaksione të dështuara
8	Informativ	Lajmërim për ndryshimin e emetimit
9	Informativ	Lajmërim për ndryshime të pjesëmarrësit
10	Informativ	Lajmërim për maturimin e ISIN, e vendosur peng
11	Gabim	Lajmërim për përjashtim nga procesimi
12	Gabim	Dështim i lajmërimit, i përsëritur
13	Informativ	Lajmërim për krijimin e ankandit repo
14	Informativ	Lajmërim për ekzekutimin e ankandit repo
15	Informativ	Lajmërim për ndryshimin e ankandit repo
16	Informativ	Lajmërim për anulimin e ankandit repo
17	Informativ	Lajmërim për ndryshimin e orarit
18	Informativ	Lajmërim për transaksion me shumë të madhe
19	Paralajmërues	Lajmërim për transaksione pezull për fonde
20	Paralajmërues	Lajmërim për transaksione pezull për tituj



SHTOJCA 7
ORARI I PUNËS I SISTEMIT AFISAR

Ora	Procedura	Aktivitetet dhe transaksionet e mundshme
8:30	Hapja e ditës	Fillimi i procedurave të hapjes së ditës
8:45	Hapja e ditës së punës	Pjesëmarrësit mund të dërgojnë dhe marrin instruksione pagesash
15:00	Mbyllja e shërbimit për ankandet e emetimit që zhvillohen brenda ditës	Pas kësaj ore, një ankand i zhvilluar me datë emetimi brenda ditës nuk mund të ekzekutohet/anulohet
15:00	Mbyllja e shërbimit për hapin e dytë të kredisë brenda ditës	Procesohet automatikisht hapi i dytë i kredisë brenda ditës me Bankën e Shqipërisë
16:00	DVP cut-off	Mbyllja e shërbimit për shlyerjen e instruksioneve të pagesave DVP
16:15	FoP cut-off	Mbyllja e shërbimit për shlyerjen e instruksioneve të pagesave FoP
16:25	Mbyllja e ditës së punës	Pas kësaj ore, janë gati raportet e fundit të ditës dhe bëhet regjistrimi i balancave në sistem, që shërben për pagesat e kuponave dhe/ose maturimet.
16:30	Mbyllja e ditës	Mbyllja e ditës në sistem



SHTOJCA 8
KOMISIONET E APLIKUARA NË SISTEMIN AFISAR

Lloji i komisioneve	Në vlerë	Në përqindje
A. Komision		
Komision hyrjeje për pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë	0 (zero)	
Komision hyrjeje për pjesëmarrësit e tërthortë	0 (zero)	
Komision hyrjeje për pjesëmarrësit jo të drejtpërdrejtë	0 (zero)	
Komision vjetor mirëmbajtjeje	250,000	
Komision daljeje	0 (zero)	
B. Komision për procesimin dhe shlyerjen		
Komision procesimi për transaksionet DVP (shitje/blerjet, Repo, Rev/Repo, marrëveshjet e kolateralit)	0 (zero)	
Komision procesimi për transaksionet FOP (transfertat e portofolit, ekzekutimi i kolateralit, zëvendësimi i titullit në një marrëveshje riblerjeje, operacionet për të plotësuar kërkesën për marzhin e ruajtjes së vlerës së titullit të tregtuar nëpërmjet marrëveshjeve të riblerjes)	0 (zero)	
Komision për procesimin e rezultateve të tregut primar	0 (zero)	
Komision për procesimin e marrëveshjeve të kolateralit financiar (regjistrimi i kolateralit, zëvendësimi i titullit në një marrëveshje kolaterali, lirimi i kolateralit, ekzekutimi i kolateralit)	0 (zero)	
Komision për riciklimin e transaksioneve të tregut primar	0 (zero)	
C. Komisione të tjera		
Përgatitja e raporteve sipas kërkesës specifike		Për t'u vlerësuar në bazë të kërkesës specifike
Komisione për organizmin e trajnimit	0 (zero)	
Komision për certifikimin e operatorëve të sistemit	0 (zero)	
Komision për pajisjen e aksesit në sistemit AFISaR		3 (tre) për pjesëmarrës falas, të tjerat me pagesë sipas kostos së pajisjes
D. Zbritjet për incentiva		
Për vëllimin e procesuar	0 (zero)	
Për kohën e procesimit	0 (zero)	



Shtojca 9 - Forma e urdhrit për pjesëmarrësit e tërthortë

Forma 1

Urdhër	
Tipi i transaksionit :	Blerje <input type="checkbox"/> Shitje <input type="checkbox"/>
Urdhëruesi:	
Llogaria e titullit:	
Data e tregtimit:	
Data e valutës:	
Kodi referencë i titullit të tregtuar (ISIN):	
Vlera nominale:	
Çmimi:	
Monedha:	
Pala në tregtim: _____ me llogarinë e titullit _____	

Forma 2

Urdhër	
Tipi i transaksionit:	Marrëveshje riblerjeje <input type="checkbox"/> Marrëveshje kolaterali <input type="checkbox"/>
Urdhëruesi:	
Llogaria e titullit:	
Data e tregtimit:	
Data e valutës:	
Kodi referencë i titullit të tregtuar (ISIN):	
Vlera nominale:	
Çmimi:	
Data e përfundimit të marrëveshjes:	
Çmimi:	
Monedha:	
Pala në tregtim: _____ me llogarinë e titullit _____	



Shtojca 10 - Informacion mbi pjesëmarrësin e drejtpërdrejtë

Informacion i përgjithshëm

Emri i institucionit: _____

Përfaqësuesi ligjor: _____

Rezidenca: Rezident Jorezident

Kodi BIC _____

Klasa sipas përcaktimit në nenin 15, pika 1, shkronja a: _____

Adresa: _____

E-mail: _____

Taksimi në burim: Po Jo

Në qoftë se “Po”, norma e taksës në përqindje ____ e vërtetuar me dokumentin bashkëngjitur.

Mënyra e komunikimit: VPN SWIFT

II. Karakteristika në lidhje me operimin e sistemit

1. Licensë për kujdestar/komisioner të titujve: Po

Në qoftë se përgjigjja është “Po”, ju lutem bashkëngjitni dokumentin që e vërteton.

2. Konfirmimi për përputhjen e mesazheve: Po

3. Keni llogari në sistemin AIPS: Po Jo

Në qoftë se përgjigjja është “Jo”, agjenti juaj shlyes është _____.

Ju lutem bashkëngjitni dokumentin që e vërteton marrëdhënien tuaj me agjentin shlyes.

Kontaktet

Person kontakti për çështje/probleme të operimit të sistemit		
Person kontakti për biznesin		
Emër, Mbiemër		
Detyra që mbulon		
Telefon		
Celular		
E-mail		
Person kontakti për IT		
Emër, Mbiemër		
Detyra që mbulon		
Telefon		
Celular		
E-mail		

Nënshkrimi: _____

Datë: _____

Nëpërmjet nënshkrimit të këtij formulari jap pranimin për përdorimin e të dhënave, në funksion të operimit të sistemit AFISaR.

**Shtojca 11 - Informacion mbi pjesëmarrësin e tërthortë****I. Person juridik**

Emri i personit juridik _____

Përfaqësuesi ligjor _____

NIPT _____

Data e regjistrimit _____

Taksimi në burim: Po Jo

Në qoftë se “Po”, norma e taksës në përqindje _____ e vërtetuar me dokumentin bashkëngjitur.

Rezidenca : Rezident Jorezident

Adresa: _____

E-mail: _____

Tel: _____

Nëpërmjet nënshkrimit të këtij formulari jap pranimin për përdorimin e të dhënave, në funksion të operimit të sistemit AFISaR.

II. Person fizik

Emër/Mbiemër _____

Numri i kartës së indentitetit _____

Datëlindja _____

Taksimi në burim: Po Jo

Në qoftë se “Po”, norma e taksës në përqindje _____

Rezidenca: Rezident Jorezident

Adresa: _____

E-mail: _____

Tel: _____

Agjenti shlyes _____

Numri i llogarisë pranë agjentit shlyes _____

Ju lutem, bashkëngjitni dokumentin vërtetues për agjentin shlyes.

Nëpërmjet nënshkrimit të këtij formulari jap pranimin për përdorimin e të dhënave, në funksion të operimit të llogarisë së titullit të hapur në sistemin e regjistrimit dhe shlyerjes së titujve AFISaR.

**Shtojca 12 - Anëtarësimi në AFISaR i një pjesëmarrësi të drejtpërdrejtë të ri****Fazat e anëtarësimit**

- I. Testimi dhe trajnimi
- II. Përgatitja e dokumentacionit
- III. Implementimi dhe kalimi në *live*

I. Testimi dhe trajnimi**1. Testimi i VPN:**

- a. instalimi dhe konfigurimi i VPN dhe lidhjes me FTP server në ambientet e institucionit kandidat;
- b. përgatitja e kërkesës për përdorues në VPN dhe FTP server nga institucioni kandidat;
- c. krijimi i përdoruesve të VPN dhe FTP server nga Administratori;
- d. testimi i VPN dhe lidhjes me FTP server nga institucioni kandidat dhe Administratori.

2. Testimi i SWIFT:

- a. në rast se institucioni do të përdorë shërbimin SWIFTNet FIN për shkëmbimin e transaksioneve me sistemin AFISaR, paraprakisht duhet të shkëmbejë autorizimet RMA me Bankën e Shqipërisë;
- b. shkëmbimi i disa mesazheve test me anë të shërbimit SWIFTNet FIN test midis institucionit kandidat dhe Administratorit.

3. Trajnimi / Testimi në sistemin AFISaR për pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë me akses në VPN:

- a. nga institucioni pjesëmarrës do të paraqitet kërkesa për përdorues në sistemin AFISaR test;
- b. nga Administratori përgatiten pajisjet e sigurisë, të cilat iu dorëzohen pjesëmarrësve dhe krijohen gjithashtu, përdoruesit në ambientin test të AFISaR;
- c. Administratori do të trajnojë dy deri në tre punonjës të institucionit kandidat për funksionalitetin e sistemit AFISaR;
- d. institucioni kandidat, në bashkëpunim me administratorin, do të ekzekutojë dokumentin e testimit dhe do ta firmosin atë.

II. Përgatitja e dokumentacionit për pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë me akses në VPN:

- a. institucioni kandidat do të përgatisë “Rregullat dhe procedurat e brendshme të funksionimit të AFISaR”, në përputhje me këtë rregullore;
- b. dokumentacioni i përfunduar do të dorëzohet pranë Administratorit për aprovim;
- c. Administratori bën vërejtjet/modifikimet e saj, nëse bie ndesh me këtë rregullore dhe/ose të tjera rregullore të Administratorit, të cilat ky i fundit ia paraqet institucionit kandidat;



- d. institucioni kandidat sjell variantin përfundimtar të “Rregullave dhe procedurave të brendshme të funksionimit të AFISaR”, ku reflektohen modifikimet sipas shkronjës c.

III. Implementimi dhe kalimi në Sistemin AFISaR *Live* për pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë me akses në VPN:

- a. përgatitja dhe dorëzimi i certifikatës së pjesëmarrjes nga Administratori për institucionin kandidat;
- b. nënshkrimi i kontratës tip të pjesëmarrjes ndërmjet Administratorit dhe institucionit pjesëmarrës, sipas Shtojcës 1;
- c. pjesëmarrësi përgatit dhe dorëzon pranë Administratorit “Informacion për pjesëmarrësin e drejtpërdrejtë”, Shtojca 10;
- d. pjesëmarrësi plotëson dhe dorëzon pranë Administratorit “Kërkesën për pajisje sigurie dhe përdorues në ambientin *live*”, Shtojca 13 dhe Shtojca 17;
- e. pjesëmarrësi plotëson dhe dorëzon pranë Administratorit “Kërkesën për ndryshime në rrjetin VPN”, Shtojca 14;
- f. pjesëmarrësi plotëson dhe dorëzon pranë Administratorit “Kërkesën për krijim përdoruesi në sistemin FTP-AFISaR”, Shtojca 18, pas miratimit të kërkesave nga Administratori, krijohet pjesëmarrësi në AFISaR, përgatiten pajisjet e sigurisë me certifikatat e përdoruesve, krijohen përdoruesit në ambientin AFISaR *live*, krijohen përdoruesit në VPN, i dorëzohen pajisjet e sigurisë pjesëmarrësit;
- g. Administratori përcakton ditën e kalimit *live* të pjesëmarrësit dhe njofton me e-mail të gjithë pjesëmarrësit e AFISaR;
- h. kalimi në *live*.

IV. Implementimi dhe kalimi në Sistemin AFISaR *Live* për pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë me akses në SWIFT:

- a. pjesëmarrësi dorëzon pranë Administratorit “Informacion për pjesëmarrësin e drejtpërdrejtë”, Shtojca 10;
- b. nënshkrimi i kontratës tip të pjesëmarrjes ndërmjet Administratorit dhe institucionit pjesëmarrës, sipas Shtojcës 1;
- c. Administratori përcakton ditën e kalimit *live* të pjesëmarrësit dhe njofton me e-mail të gjithë pjesëmarrësit e AFISaR;
- d. kalimi në *live*.



Shtojca 13 – Formular për pajisje sigurie

KONFIDENCIAL



Banka e Shqipërisë
Departamenti i Operacioneve Monetare
Kërkesë për pajisje sigurie

Tiranë, më [/ /]

Për Bankën e Shqipërisë

Autorizuesi

Institucioni _____, si pjesëmarrës në sistemin AFISaR, ka nevojë për pajisje sigurie si më poshtë:

Nr.	Emri i pajisjes	Copë	Çmimi për njësi ¹	Vlera
1				
2				

Emrat e personave (emër,mbiemër) që do të përdorin kartat:

<p>_____</p> <p>_____</p>

Për Institucionin Emetues:

Pajisjet e sigurisë u dorëzuan, sipas procesverbalit përkatës, në datë:

¹ Vlera e pajisjeve të sigurisë do t'u mbahet institucioneve nga llogaria e njoftuar nga ta, e hapur në agjentin shlyerës të përcaktuar prej tyre.



Shtojca 14 – Formular për ndryshime në rrjetin VPN

KONFIDENCIAL



Banka e Shqipërisë

Departamenti i Teknologjisë së Informacionit

Kërkesë për ndryshime në rrjetin VPN

Tiranë, më [] / [] / []

Për Bankën e Shqipërisë

Autorizuesi

Institucioni Emetues që paraqet kërkesën për ndryshime:

Arsyeja dhe detaje për ndryshimet:

Për Institucionin Emetues:

Autorizuesi i kërkesës

**Shtojca 15 – Vetëvlerësim i operimit në AFISaR**

Pjesëmarrësi: _____

Vlerësimi për vitin _____

Vlerësimet vjetore paraqiten në muajin janar të çdo viti kalendarik.

Lutemi jepni përgjigje për pyetjet e mëposhtme:**A. Veprimtaria kriminale lidhur me sistemin AFISaR**

1. A është vërejtur veprimtari kriminale apo përpjekje për veprimtari të tillë në kuadrin e AFISaR, në institucionin tuaj, gjatë vitit?
2. Nëse po, a është kryer raportimi pranë administratorit, në përputhje me rregullat dhe me procedurat e AFISaR?
3. A u identifikua metoda e përdorur dhe a u krye korrigjimi i duhur?
4. A rezultoi kjo veprimtari në humbje financiare për institucionin apo për klientët tuaj?
5. Nëse po, a po punohet ende për kompensimin e këtyre humbjeve?

B. Planifikimi i ngjarjeve të paparashikuara dhe i lehtësive përkatëse

1. A ka institucioni juaj një plan të dokumentuar për ngjarjet e paparashikuara, lidhur me operacionet në AFISaR?
2. A i mbulon plani skenarët e mundshëm në mënyrë të kënaqshme?



3. A mban institucioni juaj lehtësi *backup* kompjuterike dhe/apo për ndërfaqen SWIFT që shfrytëzohet për ndërlidhjen me AFISaR?
4. Nëse po, a janë këto lehtësi fizikisht të ndara nga vendndodhja kryesore e ambientit SWIFT?
5. A mendoni se rreziqet e mundshme për punën janë adresuar dhe janë analizuar në mënyrë të kënaqshme?

C. Periudha e ndërprerjes së operimit dhe qëndrueshmëria e sistemit

1. A keni hasur defekte apo probleme të përsëritura gjatë operacioneve të AFISaR?
2. Nëse po, a janë raportuar tek Administratori dhe a janë regjistruar në regjistrin e ngjarjeve të paparashikuara, në përputhje me procedurat e AFISaR?
3. A mendoni se sistemet tuaja të lidhura me AFISaR kanë kapacitet dhe qëndrueshmëri të mjaftueshme për të mbuluar trafikun tuaj të pagesave në kohë dhe në mënyrë të sigurt?



Shtojca 16

Raportimi i ngjarjeve të paparashikuar për muajin _____ viti _____ në sistemin AFISaR

Pjesëmarrësi: _____

Data e ngjarjes	Ora e ngjarjes	Natyra e problemit	Veprimi i ndërmarrë	Ora e rregullimit të problemit



Shtojca 17 – Formulari i kërkesës për krijim përdoruesi

FORMULARI I KËRKESËS PËR KRIJIM PËRDORUESI									
Për:	Bankën e Shqipërisë Departamenti i Operacioneve Monetare								
Nga Institucioni Emetues: _____	Data e kërkesës: __/__/____ <i>(dd/mm/vvvv)</i>								
Përdoruesve të mëposhtëm u jepen të drejtat në sistem, sipas tabelës:									
<table border="1"> <thead> <tr> <th>Emri/Mbiemri i përdoruesit</th> <th>Emri i profilit</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td> </td> <td> </td> </tr> <tr> <td> </td> <td> </td> </tr> <tr> <td> </td> <td> </td> </tr> </tbody> </table>		Emri/Mbiemri i përdoruesit	Emri i profilit						
Emri/Mbiemri i përdoruesit	Emri i profilit								
Për Institucionin Emetues Autorizuesi i kërkesës (_____)	Për Bankën e Shqipërisë Autorizuesi i kërkesës (_____)								

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë).

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 64 lekë